



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/180
Datë: 27.12.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Trajtimin e Fushës së Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE
MINISTARSTVO ZA FINANSIJE RADA I TRANSFERE / MINISTRY OF FINANCE
LABOUR AND TRANSFERS

KONCEPT DOKUMENT
PËR TRAJTIMIN E FUSHËS SË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE
LUFTIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Dhjetor 2023

Përmbajtja

Hyrje	5
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....	7
1.1. Korniza e politikave dhe e legjislacionit të Kosovës	7
1.2. Standardet ndërkombëtare dhe evropiane	13
1.3. Elaborimi i problemit kryesor	25
1.4. Palët e interesuara	56
Kapitulli 2: Objektivat	60
Kapitulli 3: Opsionet.....	62
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim	62
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit.....	63
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë [me ndryshime legjislative].....	63
3.3.1. Nën opsioni për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit	64
3.3.2. Nën opsioni për miratimin e ligjit të ri për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.....	65
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	65
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave	67
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	67
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	69
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme	71
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet	74
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm.....	76
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	77
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik	78
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	81
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	85
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore	88

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për trajtimin e fushës së parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.
Ministria bartëse	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Personi kontaktues	Flutra Blakçori Xërxa, Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës
Plani Kombëtar për Zhvillim-PKZH 2023-2025	Hartimi dhe aprovimi i Koncept Dokumentit për Luftimin e Parandalimit të Pastrimit të Parasë / Luftimi i Financimit të Terrorizmit është paraparë në Planin Kombëtar për Zhvillim-PKZH 2023-2025
Prioriteti strategjik	Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) – tek Shtylla VI – Qeverisja e Mirë, tek sektori i financave publike, sektori 02, qëllimi zhvillimor 10 - Qeveri Efektive dhe Llogaridhënëse, ka veprimin - Hartimi dhe aprovimi i Koncept Dokumentit për Luftimin e Parandalimit të Pastrimit të Parasë / Luftimi i Financimit të Terrorizmit në Planin Kombëtar për Zhvillim-PKZH 2023-2025 për zbatimin e masës strategjike.

Vendimi	
Çështja kryesore	Trajtimi i fushës së parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimi i financimit të terrorizmit, si dhe përafrimi i kësaj fushe me standardet e rishikuara të FATF-së dhe me aquis communautaire të BE.
Përmbledhje e konsultimeve	Gjatë procesit të konsultimit ndërministror që u zhvillua për koncept dokumentin nga data 08/09/2023 deri me 28/09/2023, janë pranuar komente nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Administrata Tatimore. Sa i përket komenteve nga Agjencia Kadastrale e Kosovës Grupi Punues u dakordua se duhet të trajtohen me një ligji tjetër specifik. [Listoni aktivitetet kryesore të konsultimit publik të realizuar. Gjithashtu shënoni datën e fillimit dhe datën e përfundimit të konsultimit publik përmes internetit. Listoni numrin e organizatave që ofruan përgjigje në këtë konsultim, numrin e komenteve të marra dhe përfundimet kryesore nga procesi i konsultimit publik. Referojuni raportit për konsultimin publik që duhet të dorëzohet së bashku me koncept dokumentin për miratim nga Qeveria.]
Opsioni i propozuar	Opsioni i tretë ku propozohen ndryshime legjislative

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Zbatohet në kuadër të kufijve aktual buxhetor.
Ndikimet ekonomike	Pritet të ketë ndikime në parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlydhura penale dhe luftimit të financimit të terrorizmit, zvogëlimin e ekonomisë informale dhe stabilitet ekonomik.
Ndikimet shoqërore	Pritet të ketë ndikime sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit demotivimit të kriminalitetit në këtë fushë përmes ndëshkimit të personave që kryejnë vepra të tilla penale.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ndikimet ndër-sektoriale	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori
Ngarkesat administrative për kompanitë	Zbatimi i opsionit të preferuar, ofron mundësinë e zvogëlimit të mëtejshëm të barrës administrative, sa i takon ofrimit dhe mirëmbajtjes së informacionit të obligueshëm.
Testi i NVM-ve	Nuk është aplikuar testi i NVM-ve

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Mbajtja e takimit ndërinstitucional, dhe nxjerrja e vendimit për formimin e Grupit Punues për rishikimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Aprovimi i Ligjit nga Qeveria.
Afatmesëm	Miratimi i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit nga Kuvendi. Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportues me ndryshime ligjore.

Hyrje

Koncept Dokumenti është përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve Nr. 95/2018 të datës 21/03/2018 dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qeverisë.

Ky Koncept Dokument analizon legjislacionin dhe masat për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit që ekzistojnë në Kosovë, deri në datën e finalizimit të këtij Koncept Dokumenti, si dhe nivelin e përputhshmërisë së këtij legjislacioni të Kosovës me Rekomandimet e FATF-së, legjislacionin e BE-së, si dhe nevojën e avancimit të mëtutjeshëm të këtij niveli të pajtueshmërisë.

Aktualisht fusha e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit sa i përket nivelit të pajtueshmërisë teknike ka një pajtueshmëri në masë të madhe me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Në Kosovë deri më sot, janë kryer dy vlerësime në kuadër të ndihmës teknike të dhënë nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, nëpërmjet Projektit të Përbashkët kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PECK). Këto vlerësime janë mbështetur në metodologjinë e zbatuar për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL).

Në Kosovë, cikli i parë i vlerësimit u zhvillua në periudhën 2012-2014 në kuadër të projektit PECK I. Gjetjet dhe rekomandimet e tij rezultuan më vonë në një numër nismash legjislative përtej kohëzgjatjes së projektit. Tutje në dhjetor të vitit 2018 u publikuan edhe rezultatet e ciklit të dytë të vlerësimit të përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (2018- 2019), i cili mbështetet në standardet e zhvilluara më tej dhe metodologjitë e vlerësimit të MONEYVAL.

Përparimi i bërë nga institucionet e Kosovës, sipas këtij raporti mund të gjurmohen lehtësisht duke krahasuar rezultatet e vlerësimit të parë dhe të dytë. Sipas këtij raporti, në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (PPP/LFT), niveli i përputhshmërisë është rritur për gati gjysmën e 40 Rekomandimeve të Task Forcës globale të Veprimit Financiar (FATF). Sidoqoftë, krahasimi i ri mbi efektivitetin mbetet një sfidë për t'u marrë parasysh nga autoritetet e Kosovës.

Koncept dokumenti për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, adreson edhe nevojën për rregullimin e disa çështjeve të cilat së fundmi janë rregulluar dhe avancuar në nivelin e standardeve ndërkombëtare të FATF-së dhe të BE-së, por të cilat ende nuk janë të trajtuara në kuadër të kornizës legjislative vendore për fushën e PPP/LFT dhe kjo synohet të rregullohet me politikat që propozohen me këtë koncept dokument.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për trajtimin e legjislacionit në fushën e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.
Ministria bartëse	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Personi kontaktues	Flutra Blakçori Xërxa, Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës
Plani Kombëtar për Zhvillim-PKZH 2023-2025	Hartimi dhe aprovimi i Koncept Dokumentit për Luftimin e Parandalimit të Pastrimit të Parasë / Luftimi i Financimit të Terrorizmit është paraparë në Planin Kombëtar për Zhvillim-PKZH 2023-2025
Prioritetite strategjik	Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) – tek Shtylla VI – Qeverisja e Mirë, tek sektori i financave publike, sektori 02, qëllimi zhvillimor 10 - Qeveri Efektive dhe Llogaridhënëse, ka veprimin - Hartimi dhe aprovimi i Koncept Dokumentit për Luftimin e Parandalimit të Pastrimit të Parasë / Luftimi i Financimit të Terrorizmit në Planin Kombëtar për Zhvillim-PKZH 2023-2025 për zbatimin e masës strategjike.
Grupi punues	Sipas vendimit të MF me numër protokolli 821 të datës 02/07/2020: <ol style="list-style-type: none"> 1. Flutra Blakçori Xërxa, Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës/ NjIF-K (Kryesues) 2. Mirlinda Dreshaj Berisha, Njësia për Inteligjencë Financiare/ NjIF-K (Zv. Kryesuese) 3. Shpend Lushaku, Njësia për Inteligjencë Financiare / NjIF-K (anëtar) 4. Astrit Hasani, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Ministria e Financave/ MF (anëtar) 5. Razije Murtezaj, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave/ MF (anëtare) 6. Antigona Prenaj Bekaj, Departamenti i Buxhetit, Ministria e Financave/ MF (anëtare) 7. Ganimete Abdullahu, Departamenti i Komunikimit Publik, Ministria e Financave / MF (anëtare) 8. Hasnije Bardhi, Zyrtare për Barazi Gjinore, Ministria e Financave/ MF (anëtare)

	<ol style="list-style-type: none">9. Shqipdon Fazliu, Kordinator Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike (anëtar)10. Atdhe Dema, Prokuror, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës/ PSRK (anëtar)11. Hysen Fazliu, Policia e Kosovës/ PK (anëtar)12. Agron Metolli, Policia e Kosovës/ PK (anëtar)13. Jeton Dragusha, Administrata Tatimore e Kosovës/ ATK (anëtar)14. Valbone Ymeri, Dogana e Kosovës/ DK (anëtare)15. Labinot Preniqi, Banka Qendrore e Kosovës/ BQK (anëtar)16. Trendelina Qorraj, Departamenti për Integrim Evropian dhe Kordinim të Politikave, Ministria e Drejtësisë/ MD (anëtare)17. Nita Prekazi, Departamenti për Kriteria Ekonomike dhe Treg të Brendshëm, Zyra e Kryeministrit/ ZKM (anëtare)18. Mrika Pepa, Departamenti për Kriteria Ekonomike, Zyra e Kryeministrit/ ZKM (anëtare)19. Shkurte Krasniqi, Sekretariati Koordinues Qendror, Zyra e Kryeministrit/ ZKM (anëtare)20. Dren Puka, KCSF, Organizatë e Shoqërisë Civile/ OSHC (anëtar)21. Alban Hetemi, Shoqata e Bankave të Kosovës/ SHBK (anëtar)22. Sefadin Blakaj, Oda e Noterëve të Kosovës/ ONK (anëtar)23. Venhar Hana, Shoqata e Sigurimeve të Kosovës/ SHSK (anëtar)24. Vlora Marmullakaj, Projekti Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë/ PECK III (vëzhgues).
--	--

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

1.1. Korniza e politikave dhe e legjislacionit të Kosovës

Në Republikën e Kosovës ekziston një kornizë e integruar sa i përket parandalimit të pastrimit parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Kjo kornizë ligjore, e cila është objekt elaborimi edhe në tabelën e mëposhtme, përbëhet nga aktet ligjore si në vijim:

1. Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
3. Kodi i Procedurës Penale;
4. Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
5. Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë;
6. Rregullore e Bankës Qendrore të Kosovës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
7. Ligji për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara;

8. Ligji Nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale
9. Projektligji për Regjistrin e Pronarëve Përfitues,
10. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023
11. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit - 2020
12. Plani i Veprimit i Rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të LPP/LFT-së 2020-2023,
13. Strategjia Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023 – 2028,
14. Plani Kombëtar për Zhvillim 2023-2025
15. Programi për Reforma në Ekonomi 2023-2025, si dhe
16. aktet nënligjore që derivojnë nga legjislacioni i mësipërm.

Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit - është ligji bazik sa i përket fushë së PPP/L:FT i cili përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës - në nenin 302 ka të përcaktuar veprën penale të shpërlarjes së parave ku përkrahë se kushdo që kryen veprën penale të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Ndërsa, në kuadër të Kapitullit XIV kodifikohen veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, ku janë edhe përkufizimet për dispozitat e terrorizmit.

Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës i Republikës së Kosovës - qëllimi i këtij Kodi është përcaktimi i rregullave të procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod.

Ligji Nr. 08/L-168 për Zyrën e Prokurorisë Speciale, sipas Nenit 9 paragrafit (1.1), Prokuroria Speciale ka kompetencë të veçantë lëndore mbi “veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, e cila lidhet me kapitullin XIV të Kodit Penal, i cili gjithashtu përfshin veprat penale të ndërlidhura me terrorizmin. Sa i përket veprës penale të pastrimit të parave, Prokuroria Speciale ka juridiksion mbi veprën penale të pastrimit të parave të kryer së bashku me [të tjera] “vepra penale që janë në kompetencën e PSRK-së, pavarësisht nga shuma apo përfitimi”. Gjithashtu, PSRK -ja ka juridiksion edhe për veprën penale pastrimi i parave, të kryer “si një veprë e vetme penale, nëse vlera e shumës ose përfitimit është në shumën prej pesëqind mijë (500,000) Euro ose më shumë”.

Ligji Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë - në këtë ligj përcaktohen kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë atëherë kur procedurat sipas KPPRK nuk mjaftojnë. LKZKP prezantoi një konfiskim kuazi-penal dhe shkon një hap më tej se KPPRK duke akomoduar nën kushte të caktuara konfiskimin edhe të pasurisë që nuk është e ndërlidhur me veprën e caktuar penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor.

Rregullorja e BQK-së për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, përcakton kriteret dhe procedurat e nevojshme për menaxhimin e procesit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtueshmëri me Ligjin nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe zbatohet për të gjitha bankat, degët e bankave të huaja, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve dhe institucionet financiare jo-bankare.

Ligji Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara, përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për propozimin, miratimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara në Republikën e Kosovës, të cilat kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, zhvillimin dhe forcimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe arritjes së objektivave të tjera në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, aktet e Bashkimit Evropian, vendimet e organizatave të tjera ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është anëtare ose të cilat i zbaton.

Ligji Nr. 04/L-213 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-026 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.

Projektligji për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, trajton krijimin, funksionimin, administrimin e regjistrin të pronarëve përfitues, përcakton obligimet e personave fizikë dhe subjekteve të detyruar të cilët regjistrojnë informacionin e pronësisë përfituese në regjistër, si dhe përcakton masat ndëshkuese në rast të mosrespektimit të dispozitave të këtij ligji.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023, është një dokument i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim të plotë me partnerët e saj i cili mbulon tërësinë e masave që Qeveria synon të realizojë përmes institucioneve të saj ligj zbatuese për parandalimin e të gjitha formave të ekonomisë joformale, parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe Krimeve Financiare në sektorë të ndryshëm të aktiviteteve ekonomike në Kosovë përmes Planit të Veprimit 2019-2023. Objektivat strategjike të paraparë në këtë strategji janë përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.

Raporti i Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 24.12.2020, është proces i rregulluar me nenin

18 (Vlerësimi dhe parandalimi i rrezikut) të Ligjit 05/L-096, i cili përcakton që NjIF-K-i siguron në mënyrë periodike dhe koordinon vlerësimin kombëtar të rrezikut për sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun dhe për t'i bërë rekomandime Qeverisë në përcaktimin e politikave, strategjive dhe masave për menaxhimin e rrezikut dhe për të zvogëluar rreziqet e identifikuara. Vlerësimi kombëtar i rrezikut ndërmerret së paku çdo tri (3) vite dhe Ministria e Financave bazuar në nenin 66 të Ligjit për PPP/LFT nxjerrë akt nënligjor në mënyrë që të përcaktojë procedurat që duhen ndjekur. Për këtë qëllim Ministria e Financave ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ MF- NR.04/2018 për vlerësimin e rrezikut kombëtar për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit i cili rregullon dhe përcakton procedurat standarde për një proces të përgjithshëm për vlerësimin e rrezikut kombëtar për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe ekonomisë joformale (vlerësim i rrezikut), duke përfshirë identifikimin, analizën dhe vlerësimin e rreziqeve dhe dobësitë.

Në vitin 2018 është iniciuar vlerësimi i dytë i rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë (VRK). Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, qëllimi ka qenë të identifikohen, të kuptohen dhe të vlerësohen rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me të cilat përballet Kosova. Terminologjia dhe metodologjia e VRK-së bazohet në Udhëzimin Administrativ MF- Nr.04/2018 për vlerësimin e rrezikut kombëtar për PPP/LFT dhe udhëzimin e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) Konceptet themelore për vlerësimin e rrezikut janë kërcënimet (veprat penale të përshkruara që lidhen me pastrimin e parave), cenueshmëritë (situatat që e mundësojnë pastrimin e parave), pasojat (ndikimi, cenueshmëria), dhe rreziku (sinteza e kërcënimit, cenueshmërisë dhe pasojës). Objektivi i VRK-së është që t'i kuptojë më mirë rreziqet nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në Kosovës, të informojë ndarjen efikase të burimeve dhe t'i zbusë ato rreziqe. Të kuptuarit e përmirësuar që VKR ofron i ndihmon qeverisë, agjencive të zbatimit të ligjit, mbikëqyrësve dhe sektorit privat në shënjestrimin e burimeve të tyre në fushat e rrezikut më të lartë, duke siguruar që qasja e Kosovës për parandalimin e krimit financiar është e bazuar në rrezik dhe është proporcionale.

Kapitulli i parë jep një përshkrim të metodologjisë dhe përkufizimeve të përdorura për t'i vlerësuar rreziqet e PP/FT-së në Kosovë; kapitulli i dytë paraqet rezultatet e vlerësimit të kërcënimeve nga PP-ja; kapitulli i tretë konsideron kërcënimet nga FT-ja; ndërsa kapitulli i katërt përmban rezultatet e vlerësimit të cenueshmërive nga PP/FT-ja të subjekteve të ndryshme raportuese në Kosovë.

Plani i Veprimit i Rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të LPP/LFT, është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 24/12/2020 me Vendimin Nr. 05/52 dhe ka gjithsej pesë (5) objektiva strategjik që ka në të bëjnë me: Politikat dhe Koordinimi Vendor për PPP/LFT; Sistemi Ligjor dhe Çështjet Operative; Financimi i Terrorizmit dhe Financimi i Përhapjes, Masat Parandaluese, Mbikëqyrja, Personat dhe Marrëveshjet Juridike; si dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar. Ky plan ka dhe tri shtojca ku tek shtojca 1 trajtohet (pjesa teknike), shtojca 2 (udhëzuesi për zbatimin e mjetit për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të raportit të vlerësimit), dhe shtojca 3 (mjetet për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga raporti i vlerësimit). Njësia për Inteligjencë Financiare me vendimin Nr. 05/52 është e caktuar të bëjë monitorimin e duhur të zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit për të mundësuar që të rishikoj efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me neni 14 të Ligjit Nr. 05/L – 096 për PPP/LFT, si dhe me këtë vendim është krijuar edhe grupi i punës për

të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore për parandalimin e pastrimit të parave, luftimin e financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e prioriteteve afatgjata dhe afatshkurta.

Strategjia Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023 – 2028, qëllimi i kësaj Strategjie është të mbrojë Republikën e Kosovës, qytetarët, vlerat dhe interesat e saj nga kërcënimet e terrorizmit, përmes orientimit të politikave dhe forcimit të qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Kjo strategji është e përqendruara në katër objektiva strategjike të cilat janë: Parandalimi, Mbrojtja, Ndjekja dhe Reagimi.

Plani Kombëtar për Zhvillim 2023-2025, është plan i detajuar për zhvillim dhe është njëri ndër dokumentet kryesore orientuese afatshkurtër dhe afatgjatë për Qeverinë e Kosovës dhe kontribuon në zbatimin në praktikë të të gjitha prioriteteve të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2023. Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) – tek Shtylla VI – Qeverisja e Mirë, tek sektori i financave publike, sektori 02, qëllimi zhvillimor 10 - Qeveri Efektive dhe Llogaridhënëse, ka veprimin - Hartimi dhe aprovimi i Koncept Dokumentit për Luftimin e Parandalimit të Pastrimit të Parasë / Luftimi i Financimit të Terrorizmit në Planin Kombëtar për Zhvillim-PKZH 2023-2025 për zbatimin e masës strategjike

Programi për Reforma në Ekonomi 2023-2025 është program që kontribuon në orientimin e reformave strukturore që synojnë funksionimin e ekonomisë së tregut dhe rritjen e konkurrencës, të cilat janë reflektuar edhe si bazat kryesore në Programin Qeverisës 2021-2025. Korniza e përgjithshme e politikave të Programi për Reforma në Ekonomi është kombinim i: (1) programit të rimëkëmbjes ekonomike që synon të adresojë krizat e fundit.; (2) një politike fiskale të bazuar në rregulla e orientuar drejt stabilitetit të financave publike dhe, brenda hapësirës fiskale të disponueshme, mbështetjes së rritjes ekonomike nëpërmjet investimeve kapitale dhe rritjes së financimit për fushat prioritare të zhvillimit; dhe (3) një sërë reformash strukturore prioritare që adresojnë pengesat kryesore për rritjen ekonomike, duke mbështetur zhvillimin e sektorëve konkurrues ekonomik dhe duke siguruar që rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse mbështetet mirëqenien.

Përveç këtyre, marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) është thelbi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe BE-së dhe zbatimi i saj i vazhdueshëm dhe efektiv është kyç për avancimin e Kosovës në rrugën e saj evropiane. Bashkimi Evropian u ka dhënë një rëndësi të veçantë funksionimit të sundimit të ligjit, reformave në gjyqësor dhe forcimit të kapaciteteve institucionale në kuadër të ndihmës së vet afatgjatë për Kosovën. Në këtë drejtim, lufta kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë fusha me prioritet të lartë të cilat kanë ndikim të thellë në procese të ndryshme politike, përfshirë zbatimin e ndihmës së BE-së në Kosovë që synon forcimin e kapaciteteve dhe sigurimin e efektivitetit në luftimin dhe parandalimin e këtyre fenomeneve negative.

Tutje, në kuadër të tabelës vijuese trajtohen edhe akte të tjera ligjore të cilat aktualisht nuk kanë të bëjnë me çështjen e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit, mirëpo nga grupi punues shihen si akte mbi të cilat do shtrihet ndikimi lidhur me analizën për këtë koncept dokument. Pra, aktet ligjore potencialisht të ndërlydhura me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit janë:

1. Ligji për Shoqëritë Tregtare;
2. Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo Qeveritare;

Kësisoj, në tabelën si më poshtë numërohen aktet ligjore dhe nënligjore relevante për çështjen e trajtuar në këtë Koncept Dokument, identifikohen institucionet që janë përgjegjëse për zbatim dhe kompetencat përkatëse të këtyre institucioneve.

1.2. Standardet ndërkombëtare dhe evropiane

Gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka marrë parasysh një numër të instrumenteve ndërkombëtare që ndërlidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Marrë parasysh fushëveprimin e këtij Koncept Dokumenti, analizimi i bërë për qëllime të këtij seksioni është përqendruar më tepër në standardet ndërkombëtare të FATF¹ dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian lidhur me këtë fushë.

Rekomandimet e FATF përcaktojnë një kornizë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të masave që vendet duhet të zbatojnë për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Këto rekomandime përcaktojnë një standard ndërkombëtar, të cilin vendet duhet ta zbatojnë përmes masave të adaptuara sipas rrethanave të tyre të veçanta.

Dyzet Rekomandimet e FATF-së u hartuan për herë të parë në vitin 1990 si një nismë për të luftuar keqpërdorimin e sistemeve financiare nga persona që pastronin para të drogës. Në vitin 1996, Rekomandimet u rishikuan për herë të parë për të pasqyruar tendencat dhe teknikat në zhvillim të pastrimit të parave, dhe për të zgjeruar qëllimin e tyre përtej pastrimit të parave të drogës. Në Tetor 2001 FATF zgjeroi mandatin e saj për t'u marrë me çështjen e financimit të akteve terroriste dhe organizatave terroriste, dhe ndërmori hapin e rëndësishëm për krijimin e Tetë Rekomandimeve Speciale (më vonë të zgjeruara në Nëntë) për Financimin e Terrorizmit.

Rekomandimet e FATF u rishikuan për herë të dytë në 2003, dhe këto, së bashku me Rekomandimet Speciale, janë miratuar nga mbi 180 vende dhe janë njohur universalisht si standard ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Pastaj, në vitin 2012 kemi standardet e FATF që janë rishikuar për të forcuar garancitë globale dhe për të mbrojtur më tej integritetin e sistemit financiar duke u siguruar qeverive mjete më të forta për të ndërmarrë veprime kundër krimit financiar. Këto standarde janë në fuqi duke pësuar vazhdimisht përditësime me qëllim të ngritjes së efektivitetit të sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Rekomandimet e FATF përcaktojnë masat kryesore që vendet duhet të kenë për:

- identifikimin e rreziqeve dhe zhvillimin e politikave dhe koordinimin e brendshëm;
- ndjekjen e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes;
- zbatimin e masave parandaluese për sektorin financiar dhe sektorët e tjerë të përcaktuar;

¹ Financia Action Task Force Recommendation <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF%20Recommendations%202012.pdf>

- vendosjen e kompetencave dhe përgjegjësiive për autoritetet kompetente (p.sh., autoritetet hetimore, të zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrjen) dhe masa të tjera institucionale;
- ngritjen e transparencës dhe disponueshmërinë e informacionit të pronësisë përfituese të personave juridikë dhe marrëveshjeve ligjore; dhe
- lehtësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Standardet e FATF përmbajnë Rekomandimet dhe Shënimet e tyre Interpretuese, së bashku me përkufizimet e zbatueshme në fjalor. Masat e përcaktuara në Standardet e FATF duhet të zbatohen nga të gjithë anëtarët e FATF dhe FSRB², dhe zbatimi i tyre vlerësohet në mënyrë rigoroze përmes proceseve të Vlerësimit të Ndërsjellë dhe përmes proceseve të vlerësimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore – mbi bazën e metodologjisë së përbashkët të vlerësimit të FATF.

Kosova duke mos qenë anëtare e një FSRB ka kryer dy vlerësime, por këto vlerësime janë kryer në kuadër të projektit të përbashkët “Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë” të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, i cili projekt është në vazhdimësi në Kosovë që nga viti 2012. Vlerësimet e kryera në kuadër të Projektit ndjekin metodologjinë e mekanizmit monitoruese të Këshillit të Evropës, përkatësisht MONEYVAL dhe këto vlerësime kanë rezultuar në gjetje dhe rekomandime konkrete, por gjithashtu u kanë ofruar institucioneve të Kosovës përvojë praktike në planifikimin, zbatimin dhe bashkërendimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke mundësuar që Kosova të përafrohet me standardet e pranuar ndërkombëtare në këtë fushë.

Krahas standardeve të FATF, i rëndësishëm për analizën e këtij Koncept Dokumenti është edhe legjislacioni i Bashkimit Evropian konkretisht Direktiva e Bashkimit Evropian 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 maj 2015, “për parandalimin e përdorimit të sistemi financiar për pastrim parash ose qëllime të financimit të terrorizmit, duke ndryshuar Rregulloren (BE) Nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizimin e Direktivës 2005/60 / KE të Parlamentit Evropian dhe të Direktivës së Këshillit dhe Komisionit 2006/70/KE”, e ndryshuar nga Direktiva e Bashkimit Evropian 2018/843 e Parlamenti Evropian dhe e Këshillit, e datës 30 maj 2018.

Sipas, analizës së vlerësimit të kryer nga ekspertët e Këshillit të Evropës në kuadër të raportit të Vlerësimit e PPP/LFT 2017, nën SHTOJCEN Gjetjet kyçe rreth Përputhshmërisë së Kosovës me Direktivën e 4-të PPP së Bashkimit Evropian do të duhej t’ju nënshtrohen rishikimit nga grupi punues gjatë procesit të hartimit të amendamenteve të ligjit për PPP/LFT.

² FATF Style Regional Body

Së fundmi, në shkurt të vitit 2018, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan Direktivën e lartcekur të Bashkimit Evropian 2018/843 me qëllim të vendosjes së një regjim më të unifikuar lidhur me çështjet si në vijim:

- Përmirësimi i transparencës ndaj pronarëve të vërtetë të kompanive dhe trusteve për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit përmes strukturave të errëta;
- Përmirësimi i punës së njësisë të inteligjencës financiare me ndërlidhjen e regjistrave të pronësisë përfituese në nivelin e BE;
- Trajtimi i rreziqeve të financimit të terrorizmit të ndërlidhura me përdorimin anonim të valutave virtuale dhe të instrumenteve tjera të parapagimit “pre-paid”;
- Përmirësimi i bashkëpunimit dhe forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve të mbikëqyrjes financiare, mbikëqyrësve të PPP/LFT dhe me Bankën Qendrore Evropiane; si dhe
- Zgjerimi i kriterëve për vlerësimin e vendeve të treta me rrezik të lartë dhe sigurimi i një niveli të lartë të masave mbrojtëse për flukset financiare dhe përmirësimi i kontroleve për transaksione nga vendet e tilla.

Tutje, Komisioni Evropian me datë 20 Korrik 2021 ka paraqitur një pako të propozimeve legislative për të forcuar rregullat e BE-së kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit³. Kjo pako legislative përbëhet nga katër (4) propozime legislative si në vijim:

- Rregullore për krijimin e një Autoriteti të ri për PPP/LFT në nivel të BE-së;
- Rregullore për PPP / LFT, që përmban rregulla direkt të zbatueshme, përfshirë fushën e Kujdesit të Duhur ndaj Klientit dhe Pronësisë Përfituese;
- Direktivën e gjashtë për PPP/LFT (“AMLD6”), duke zëvendësuar Direktivën ekzistuese 2015/849/EU (direktiva e katërt e PPP e ndryshuar nga direktiva e pestë e PPP), që përmban dispozita që do të transpozohen në legjislacionin kombëtar, siç janë rregullat për mbikëqyrësit kombëtar dhe Njësitë e Inteligjencës Financiare në Shtetet Anëtare; dhe
- Rishikim i Rregullores 2015 për Transferet e Fondeve për të gjurmuar transferimet e krypto-aseteve (Rregullorja 2015/847 / BE).

³ European Commission (2021), Beating financial crime: Commission overhauls anti-money laundering and countering the financing of terrorism rules, Available at https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_3690, accessed on 25 May 2022

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji Nr. 05/L -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540	Njësia për inteligjencë Financiare Bordi i Njesisë për Inteligjencë Financiare	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: NJIF-K është institucioni qendror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave, përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Bordi Mbikëqyrës i Njesisë për Inteligjencë Financiare, mbikëqyrë dhe siguron pavarësinë e NjIF-K, por nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatimi kundrejt NjIF-K. Bordi ka të përcaktuara disa autorizime përfshirë rishikimin, miratimin dhe të refuzimin e raporteve të NjIF-K, emërimin, shkarkimin si dhe vëzhgimin dhe vlerësimin e performancës së Drejtor të NjIF-K, miratimin e rregulloreve për organizimit të brendshëm të NjIF-K sipas propozimit të Drejtorit, caktimin e buxhetit, vëzhgimin e pasurisë së deklaruar nga Drejtori, si dhe kryen funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuara, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional në pajtim me qëllimet e këtij ligji. Për këtë qëllim mund të ftojë edhe akterë tjerë nga sektori publik dhe privat.</p>

		<p>Banka Qendrore e Kosovës</p> <p>Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës</p> <p>Dogana e Kosovës</p> <p>Zyrat Kadastrale Komunale</p> <p>Subjektet jo publike që i nënshtrohen aktiviteteve që mund të ndërlidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit</p>	<p>Zbatimi i legjislacionit: BQK kryen mbikëqyrjen e pajtueshmërisë për subjektet raportuese në nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të nenit 16 të këtij ligji, sipas kompetencave të dhëna me këtë ligj.</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të përshkruara në nenin 56 dhe 57 të këtij Ligji hyjnë në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të themeluar me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Kontrollon deklarimin e detyruar të qarkullimit të instrumenteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Kur bartja e të drejtave mbi pronën e paluajtshme përfshin transaksion ose transaksione në një vlerë monetare dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, nuk regjistron transferin e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme derisa nuk pranon, krahas dokumenteve të tjera që paraqiten në pajtim me ligjin për regjistrimin e transferit, një deklaratë, në mënyrën dhe formën e saktësuar nga NjIF-K.</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Subjektet e përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji ndërmarrin veprimet dhe masat për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të përcaktuar me këtë ligj</p>
<p>Kodi Penal i Republikës së Kosovës</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Zbatimi i legjislacionit: Neni 302 i kodit penal përcakton veprën penale të shpërlarjes së parave – kushdo që kryen veprën penale</p>

		Gjykatat	të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Neni 131 i kodit penal përcakton veprën penale të Lehtësimit dhe financimit në kryerjen e terrorizmit
Kodi i Procedurës Penale	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759	Ministria e Drejtësisë Gjykatat Prokuroria	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Qëllimi i Kodit të Procedurës Penale është përcaktimi i rregullave të procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod.
Ligji Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=84236	Prokuroria Speciale	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Prokuroria Speciale ka kompetencë të veçantë lëndore mbi “veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, e cila lidhet me kapitullin XIV të Kodit Penal, i cili gjithashtu përfshin veprat penale të ndërlidhura me terrorizmin. Sa i përket veprës penale të pastrimit të parave, Prokuroria Speciale ka juridiksion mbi veprën penale të pastrimit të parave të kryer së bashku me [të tjera] “vepra penale që janë në kompetencën e PSRK-së, pavarësisht nga shuma apo përfitimi”. Gjithashtu, PSRK -ja ka juridiksion edhe për veprën penale pastrimi i parave, të kryer “si një vepër e vetme penale, nëse vlera e shumës ose përfitimit është në shumën prej pesëqind mijë (500,000) Euro ose më shumë”.
Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18337	Ministria e Drejtësisë	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit

		Gjykatat Prokuroria	Zbatimi i legjislacionit: Ky Ligj përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë atëherë kur procedurat e detajuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës nuk janë të mjaftueshme.
Rregullore e Bankës Qendrore të Kosovës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit	https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Rregullore%20per%20parandalimin%20e%20pastrimit%20te%20parave%20.pdf	Banka Qendrore e Kosovës	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: BQK-ja mbikëqyrë institucionet financiare në aspektin e pajtueshmërisë me detyrimet sipas Ligjit për PPP/LFT dhe kësaj Rregulloreje. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha bankat, degët e bankave të huaja, institucionet mikro-financiare, institucionet financiare jo-bankare dhe siguruesit.
Ligji për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68497	Ministria e Punëve të Jashtme	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Ministria përgjegjëse për punë të jashtme mbikëqyr zbatimin e këtij ligji. Gjithashtu, harton raportin vjetor lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe të njëjtin e dërgon në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, përpilon statistika dhe kur e konsideron të arsyeshme harton raporte dhe duke u bazuar në to bënë rekomandime organeve kompetente në lidhje me masat që duhet të ndërmerren dhe legjislacioni që duhet të miratohet për të zbatuar këtë ligj. NjIF-K është autoritet kompetent për inspektimin dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese të përcaktuara sipas këtij ligji dhe sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Terrorizmit, për sa i përket pajtueshmërisë me kërkesat e këtij ligj dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

		<p>Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria e Shtetit, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, NjIF-K, Dogana, ATK, Departamenti për Kontrollin e Mallrave Strategjike</p> <p>Ministri përgjegjës për Financa, Bordi Mbikëqyrës i NjIF-K, Qeveria</p>	<p>Akterët tjerë relevant: Ministria përgjegjëse për punë të brendshme, ministria përgjegjëse për punë të jashtme, ministria përgjegjëse për tregti dhe industri, Prokuroria e Shtetit, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, NjIF-K, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore si dhe institucionet e tjera, të cilat në kuadër të fushëveprimit të tyre janë vënë në dijeni ose kanë arsye për të besuar se një person është terrorist, është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit, financimit të terrorizmit, i përfshirë në aktivitete të një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist ose është i ndërlidhur me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, janë të detyruar të dorëzojnë propozimin për përcaktim tek ministri përgjegjës për financa, dhe të propozojnë marrjen e masave në përputhje me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>Zbatimi i legjislacionit:</p> <p>Shqyrtimin e propozimit për listim në listën vendore e bën ministri përgjegjës për financat i cili mund të thërrasë Bordin si një komitet të posaçëm këshillimor që të mblihet pa vonesë nga pranimit i propozimit.</p> <p>Ministri përgjegjës për financat, pa vonesë, i propozon Qeverisë për përcaktimin e personave në listën vendore dhe marrjen e masave të parashikuara me ligjin për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara</p>
<p>Ligji Nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8871</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.</p>

<p>Projektligji për Regjistrin e Pronarëve Përfitues</p>	<p>https://konsultime.t.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41828</p>	<p>Ministria e Industrisë Tregtisë dhe Ndërmarrësisë</p> <p>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Qëllimi i këtij Projektligji është krijimi, funksionimi, administrimi i regjistrin të pronarëve përfitues, përcaktimi i obligimeve të personave fizikë dhe subjekteve të detyruar të cilët regjistrojnë informacionin e pronësisë përfituese në regjistër dhe ngritjes së transparencës së pronësisë përfituese, si dhe përcaktimi i masave ndëshkuese në rast të mosrespektimit të dispozitave të këtij ligji.</p>
<p>Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023</p>	<p>https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/DBA6BCC4-B875-4A30-9FDB-C144736597B2.pdf</p>	<p>Ministria e Financave Punës dhe Transfereve</p>	<p>Hartimi i strategjisë dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Institucionet relevante: Ministria e Financave, kryesuese; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Zyra e Kryeministrit; Ministria për Integrim Evropian; Policia e Kosovës; Dogana e Kosovës; Administrata Tatimore e Kosovës; Banka Qendrore e Kosovës; Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës; Agjencia e Statistikave të Kosovës; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Ministria e Drejtësisë; Koordinatori Kombëtar për luftimin e krimit ekonomik.</p>
<p>Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2020-2023</p>	<p>https://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/02/NRA_Final_2020_Albanian_final_12-2020.pdf</p>	<p>Njësia për Inteligjencë Financiare</p>	<p>Hartimi i Vlerësimit të Rrezikut dhe mbikëqyrja e zbatimit koordinohet nga Njësia për Inteligjencës Financiare</p> <p>Akterët tjerë relevant: Këshilli Prokurorial i Kosovës; Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit; Administrata Tatimore e Kosovës; Policia e Kosovës; Doganat e Kosovës; Agjencia e Kosovës për Inteligjencë; Ministria e Financave e Kosovës; Banka Qendrore e Kosovës; Shoqata e Bankave të Kosovës; Oda e Noterëve të Kosovës; Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar</p>

<p>Plani i Veprimit i Rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të LPP/LFT-së 2019 – 2023</p>	<p><u>N/A</u></p>	<p>Njësia për Inteligjencë Financiare</p>	<p>Plani i Veprimit koordinohet nga Njësia për Inteligjencë Financiare</p> <p>Akterët tjerë relevant: Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/ARBK, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe Prokuroria Speciale e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, Policia e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.</p>
<p>Strategjia shtetërore për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit 2023 – 2028</p>	<p>https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/2658/Alb_Pjesa%20narrative_Strategjia%20Shtet%20C3%ABrore%20p%C3%ABr%20Parandalimin%20dhe%20Luftimin%20e%20Terrorizmit%202023%20-%202028.pdf</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p>	<p>Hartimi i strategjisë dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Sekretariati i Strategjive në MPB ka përgjegjësi monitorojë në baza të rregullta zbatimin e strategjisë</p> <p>Akterët tjerë relevant, Koordinatori Nacional për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit, Sekretariati i Strategjive, Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Forenzikë, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Dogana e Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, Zyra për mbrojtjen dhe ndihmë të viktimave, Komisioni i Pavarur i Mediave, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës,</p>

			Agjencia për Privatësi dhe Informacion, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
Plani Kombëtar për Zhvillimi 2023-2025	https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-RKS-Plani-Kombetar-per-Zhvillim-2023-2025.pdf	Sekretariati Koordinues i Qeverisë	<p>Sekretariati Koordinues i Qeverisë ka rol koordinues për këtë Plan.</p> <p>Akterët tjerë relevant: Të gjitha ministrinë dhe agjencitë e Republikës së Kosovës.</p>
Programi për Reforma në Ekonomi 2023-2025	https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/579CD1AE-3C87-4D9C-BA68-137232AED801.pdf	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	<p>Hartimi i programit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Akterët tjerë relevant: Zyra e Planifikimit Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe koordinatorët e fushave të politikave nga ministrinë e linjës.</p>
Ligji për Shoqëritë Tregtare	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16426	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës funksionon si organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe bën regjistrimin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë, si dhe është e autorizuar për kryerjen e funksioneve të tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo funksioneve që i janë caktuar ARBK me ligje të tjera.</p> <p>Ky ligj zbatohet për të gjitha shoqëritë tregtare dhe subjektet tjera të përcaktuara në këtë ligj. Rregullat për lëshimin e lejeve, licencave ose formave të tjera të lejimit, rregullimi i aktiviteteve në të cilat angazhohet shoqëria tregtare pas</p>

			regjistrimit, kontabiliteti, raportimi financiar, tatimet si dhe praktikat e punës dhe punësimit të shoqërive tregtare nuk janë në fushëveprim të këtij ligji, përveç shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemeve elektronike të institucioneve përgjegjëse për këto fusha në ARBK, duke përfshirë institucionet përgjegjëse për administratën tatimore dhe raportimin financiar
Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo Qeveritare	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055	Departamentin për Organizata Joqeveritare në kuadër të Ministrisë përkatëse për regjistrim dhe çregjistrim të OJQ-ve	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Ky ligj përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, pezullimin, shuarjen, ndalimin e veprimit dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe dispozitat e këtij Ligji zbatohen për personat juridik të organizuar dhe regjistruar si organizatë joqeveritare në Republikën e Kosovës.</p>

1.3. Elaborimi i problemit kryesor

Pajtueshmëria e vendit me standardet ndërkombëtar për PPP/LFT luan një rol të rëndësishëm në rritjen e integritetit të sistemit financiar të vendit dhe botës. Meqenëse, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit mund të ndodhë përmes shumë rrugëve të ndryshme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, vetë standardi është bërë po aq fushë e gjerë, duke nxitur vazhdimisht zgjerim dhe ngritjen e standardit.

Tutje, si rrjedhojë e ndryshimeve dhe ngritjes së standardeve të FATF-së, gjatë viteve të fundit, edhe kuadri legjislativ i BE-së për të luftuar pastrimin e parave është përditësuar rregullisht. Megjithatë, korniza ekzistuese e BE ende konsiderohet se vuan nga një numër mangësish. Kjo është arsyeja pse Komisioni Evropian paraqiti një plan veprimi për një sistem të ri të BE-së kundër pastrimit të parave. Duke arritur në planin e veprimit, më 20 korrik 2021 Komisioni Evropian paraqiti propozimin e tij legjislativ duke sjellë mbikëqyrje në nivel të BE -së të çështjeve të caktuara që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Këto ndryshime të lartcekura padyshim se ndikojnë dhe duhet të reflektojnë edhe në kornizën legjislative në Kosovë për PPP/LFT. Miratimi i fundit i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit në Kosovë është bërë në vitin 2016, andaj edhe pajtueshmëria e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare dhe evropiane kërkon avancime dhe plotësim-ndryshime të mëtutjeshme me qëllim të ndjekjes së trendëve dhe fenomeneve të reja në këtë fushë.

Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit bazohet në masë të madhe në standardet ndërkombëtare të miratuara nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) dhe Direktivat e BE-së, të cilat janë miratuar për t'iu përshtatur kontekstit të Kosovës. Megjithatë në çdo rast do të ishte i nevojshëm një rishikim i Ligjit për PPP/LFT për ta përditësuar atë në përputhje me Rekomandimet e rishikuara të FATF dhe Direktivën e Bashkimit Evropian 2018/843 e Parlamenti Evropian dhe e Këshillit, e datës 30 maj 2018 e njohur si Direktiva e V-të e BE-së.

Po ashtu, natyra e ndryshueshme në vazhdimësi e kërcënimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e nxitur nga zgjuarsia e pakufishme e kriminelëve e shoqëruar me evolucionin e vazhdueshëm teknologjik të kanaleve të shpërndarjes, kërkon rishikimin periodik, dhe aty ku është e nevojshme, rishikimin e kuadrit ligjor për të luftuar kërcënime të tilla.

Sa i përket legjislacionit aktual në Kosovë në krahasime standardet e FATF-së dhe Direktivës së Bashkimit Evropian 2015/849 për parandalimin e përdorimit të sistemi financiar për pastrim parash ose qëllime të financimit të terrorizmit e njohur si Direktiva e IV e BE-së, kemi një përafrim në një nivel të lartë, megjithatë nga vlerësimi i lartcekur janë konstatuar disa mos-pajtueshmëri të cilat kryesisht janë të natyrës teknike. Tek Shtojca II e Raportit të Vlerësimit të Pajtueshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare tek gjetjet kyçe të përputhshmërisë së Kosovës me Direktivën e 4-të të BE-së për PPP janë përshkruar mangësitë e identifikuar tek Vlerësimin i Rrezikut dhe Qasja e Bazuar në Rrezik, Kujdesi i Duhur ndaj Klientit, Detyrimet për Raportim, Mbrojtja e të Dhënave, Mbrojtja e Regjistrave dhe të Dhënave Statistike, si dhe Politikat Procedurat dhe Mbikëqyrja.

Në disa rekomandime siç janë Rekomandimi 6 (sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit), Rekomandimi 7 (sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me përhapjen) dhe rekomandimi 17 (mbështetja tek palët e treta) Kosova gjendej në mos pajtueshmëri. Mirëpo, sa i përket Rekomandimit 6 dhe 7 autoritetet kanë iniciuar ndërmarrjen e veprimeve konkrete duke hartuar fillimisht Koncept Dokumentin për Sanksionet Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara, dhe pastaj duke hartuar dhe miratuar edhe Ligjin Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara i cili u shpall me Dekretin Nr.DL-349/2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhe publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 37/27 Dhjetor 2022. Ky ligj ka adresuar mangësitë e identifikuar sa i përket rekomandimit 6 dhe 7.

Sa i përket disa rekomandimeve tjera tek pajtueshmëria teknike, kërkohet të bëhen disa korrigjim, ku me disa ndryshime të vogla teknike mund të arrihet pajtueshmëria.

Direktiva e Bashkimit Evropian 2018/843 e Parlamenti Evropian dhe e Këshillit, e datës 30 maj 2018 e njohur si Direktiva e V, ka sjellë disa ndryshime të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e transparencës ndaj pronësisë përfituese, përmirësimi i punës së njësisve të inteligjencës financiare me ndërlidhjen e regjistrave të pronësisë përfituese në nivelin e BE, trajtimi i rreziqeve të financimit të terrorizmit të lidhura me përdorimin anonim të valutave virtuale dhe të instrumenteve tjera të parapagimit “pre-paid”, përmirësimi i bashkëpunimit dhe forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve të mbikëqyrjes financiare, mbikëqyrësve të PPP/LFT dhe me Bankën Qendrore Evropiane; si dhe zgjerimi i kriterëve për vlerësimin e vendeve të treta me rrezik të lartë dhe sigurimi i një niveli të lartë të masave mbrojtëse për flukset financiare si dhe përmirësimi i kontrolleve për transaksione nga vendet e tilla.

Lidhur me Direktivën e V-të duke pasur parasysh se përveç tjerash, trajtohen dhe rregullohen edhe disa çështje në nivelin e BE-së atëherë, Kosova duke mos qenë vend anëtarë i BE praktikash disa nga këto dispozita nuk mund t’i transpozoi në legjislacionin vendorë në Kosovë si p.sh tek transparenca e pronësisë përfituese kërkesa për ndërlidhjen e regjistrave të pronësisë përfituese në nivelin e BE-së, apo dispozitat e forcimit të bashkëpunimit midis autoriteteve të mbikëqyrjes financiare, mbikëqyrësve të PPP/LFT me Bankën Qendrore Evropiane.

Megjithatë tek Direktiva e V ka shumë çështje të cilat kërkojnë ndërmarrjen e një sërë veprimesh me qëllim të arritjes së transpozimit të tyre. Lidhur me transparencën e pronësisë përfituese është bërë një analizë e detajuar e situatës aktuale në Kosovë dhe është hartuar Udhëzimi Administrativ MF (NjIF-K) 01/2021 për Pronarin Përfitues për Subjektet Raportuese. Në Qershor të vitit 2019 është hartuar një Dokument Teknik “Rekomandimet për Transparencën e Pronësisë Përfituese si Përgjigje ndaj Raportit të Vlerësimit për Kosovën”. Ky dokument teknik analizon implikimet e gjetjeve kryesore dhe veprimet e rekomanduara në Rezultatit e Menjëhershëm 5 të Raportit të Vlerësimit dhe bën rekomandime për hapat praktikë për të adresuar gjetjet dhe veprimet e rekomanduara. Përveç kësaj, ky Dokument Teknik bën rekomandime për të adresuar një regjimin të plotë për informata adekuate, të sakta dhe aktuale të pronësisë përfituese për të gjithë personat juridikë që duhet të mbahen në Kosovë sipas kriterëve 24.6 dhe 24.7 të Rekomandimit 24 në

Shtojcën e Pajtueshmërisë Teknike të Raportit të Vlerësimit, duke trajtuar edhe ndryshimet e nevojshme të cilat duhet bërë në legjislacionin në Kosovë me qëllim të arritjes së pajtueshmërisë.

Tutje, në Tetor të vitit 2020 është bërë një analizë krahasuese e legjislacionit të shteteve të Ballkanit Perëndimor për Regjistrimin e Pronësisë Përfituese “ Beneficial ownership registration in the Western Balkans – An analysis of the legal framework in Albania, Kosovo, Montenegro and North Macedonia” dokument i cili ofron të dhëna dhe mundëson për të kuptuar përparësitë dhe mangësitë e identifikuara në legjislacionet e këtyre vendeve me qëllim të rregullimit të kësaj fushe më pajtueshmëri me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare dhe evropiane.

Kosova duke pasur parasysh dokumentet e lartcekura dhe nevojën për rregullimin e fushë që ndërlidhet me identifikimin e pronësisë përfituese ka krijuar grupin punues për të hartuar Koncept Dokumentin për Regjistrimin e Pronësisë Përfituese i cili është miratuar nga Qeveria me Vendimin Nr. 22/86 të datë 04/07/2022. Po ashtu me Vendimin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Ref. 02/Nr. 320, datë 06/10/2022 është krijuar Grupi Punues për hartimin e Projektligjit për Regjistrimin e Pronësisë Përfituese.

ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË TEKNIKE TË LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË FATF

Në këtë pjesë shtjellohet dhe analizohet niveli i përputhshmërisë me 40 Rekomandimet e FATF-së sipas renditjes së tyre, bazuar edhe në gjetjet dhe rekomandimet nga Raporti i Përputhshmëria me Standardet Ndërkombëtare të PPP/LFT për Kosovën.

Rekomandimi 1 – Vlerësimi i rrezikut dhe zbatimi i qasjes së bazuar në rrezik

Sa i përket pajtueshmërisë lidhur me këtë rekomandim janë identifikuar disa çështje: duhet bërë ndryshim që ndërlidhen me kriterin (1.7) për të adresuar mungesën e një mekanizmi legjislativ ose rregullator, nëpërmjet të cilit subjektet raportuese detyrohen të marrin parasysh rreziqet e larta të PP/FT-së të identifikuara nga autoritetet e Kosovës dhe as t'i përfshijnë ato në vlerësimet e tyre të rrezikut.

Po ashtu kriteri 1.8 ka konsideruar se masat e thjeshtuara për zbatimin e Rekomandimeve të FATF-së janë parashikuar në situata ku entiteti ka identifikuar rrezikun si të ulët dhe kjo është konfirmuar nga NJIF dhe mbikëqyrësit sektorialë por nuk ka kërkesë që rreziku i ulët të jetë në përputhje me rreziqet e identifikuara në nivel kombëtar.

Kriteri (1.10), (1.11) dhe (1.12) duhet të parashihen detyrimi për subjektet raportuese për ndërmarrjen e veprimeve për zbutjen e rrezikut dhe mbajtjen e vlerësime të përditësuara, jo vetëm kur ato përcaktojnë se rreziku i PP/FT-së është i lartë por edhe në rrethana të tjera. Po ashtu të kërkohet që këto politika dhe procedura të miratohen nga drejtuesi i lartë i organizatës dhe kërkesa për të monitoruar zbatimin e kontrolleve të orientuara nga rreziku dhe për t'i rritur ato nëse është e nevojshme.

Që nga miratimi i raportit të vlerësimit, FATF ka ndryshuar këtë rekomandim duke kërkuar nga shtetet që po ashtu të vlerësojnë rrezikun e financimit të përhapjes (duke e bërë të qartë se ky

vlerësim i referohet vetëm dhe vetëm shkeljeve të mundshme, moszbatimin ose ikjen nga obligimet e sanksioneve të shënjestruara financiare të cilave u referohet në Rekomandim). Rekomandimet e rishikuara u kërkojnë po ashtu shteteve që të ndërmarrin veprime proporcionale me qëllim të sigurimit se këto rreziqe janë mënjanuar në mënyrë të efektshme, duke përfshirë caktimin e një autoriteti ose mekanizmi për të bashkërenditur veprimet për të vlerësuar rreziqet dhe ndarë burimet në mënyrë efikase për këtë qëllim. Aty ku shtet identifikojnë rreziqe më të larta do duhej që të sigurojnë se i adresojnë rreziqet të tilla në mënyrë të përshtatshme. Aty ku shtetet identifikojnë rreziqe më të ulëta, do duhej që të sigurojnë se masat e zbatuara janë në përputhje me nivelin e rrezikut të financimit të përhapjes duke njëkohësisht siguruar zbatimin e plotë të sanksioneve të shënjestruara financiare siç kërkohet në Rekomandimin 7.

Për në fund, ky rekomandim kërkon po ashtu nga institucionet financiare dhe bizneset dhe profesionet e përcaktuara jo-financiare (BPPJF-të) që të identifikojnë, vlerësojnë dhe ndërmarrin veprim efektiv për të mënjanuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe rreziqet e financimit të tyre.

Që prej Vlerësimit të Ligjit PPP/LFT i 2018 të Këshillit të Evropës, Direktiva e 5-të e BE-së lidhur me LPP/LFT ka zgjeruar llojet e subjekteve raportuese që i nënshtrohen kërkesave të ligjit PPP/LFT për të përfshirë gjithashtu:

- Çfarëdo personi tjetër që ndërmerr dhënie e, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes personave të tjerë me të cilat personi tjetër është i afërm, ndihmës materiale, asistencën ose këshillimin lidhur me çështje të tatimeve si biznes kryesor ose aktivitet profesional;
- Agjentët e patundshmërisë përfshirë kur veprojnë si ndërmjetës në lënie e pronës së paluajtshme por vetëm në lidhje me transaksionet për të cilat shuma e qirasë mujore arrin në 10 000 EUR ose më shumë;
- Ofruesit e angazhuar në shërbimet e shkëmbimit në mes të monedhave virtuale dhe ato reale;
- Ofruesit e kujdestarëve të portofoleve;
- Personat që tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetës në tregtinë e punëve të artit, duke përfshirë kur kjo bëhet nga galeritë e artit dhe shtëpive të ankandit, ku vlera e transaksionit ose i serive të transaksioneve arrin në shumën e 10 000 EUR ose më shumë;
- Personat që ruajnë, tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetësues në tregtimin e punimeve të artit kur kjo bëhet nga portet e lira, ku vlera e transaksionit ose i serive të transaksioneve arrin në shumën e 10 000 EUR ose më shumë;

Gjithashtu, FATF ka shtuar ofruesit e shërbimeve të aseteve virtuale (VASP) në kërkesat e PPP/LFT.

Rekomandimi 2 – Bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar

Kriteri 2.4 – Lidhur me këtë pikë sa i përket zbatimit të sanksioneve të shënjestruara financiare të lidhura me financimin e terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë kërkohet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që është përgjegjëse për bashkërendimin e zbatimit të sanksioneve të lidhura me FP-në (në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare) të intensifikojë bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve

përfshirë edhe Komision për kontrollin e tregtisë së mallrave strategjike, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik, si dhe mekanizmat e ndërlidhur në fushën kundër terrorizmit dhe menaxhimit të integruar të kufirit. Në këtë fushë nga vlerësuesit është konsideruar se miratimi i Projektligjit të hartuar për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare Financiare të Shënjestruara do të mbulonte zbrazëtitë e këtij bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar të munguar.

Autoritetet vendore me qëllim të adresimit të këtij rekomandimi kanë miratuar Ligjin Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare Financiare të Shënjestruara i cili ka sjell ndryshime e nevojshme për të adresuar rekomandimin lidhur me mungesën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit kombëtar lidhur me zbatimin e sanksioneve të shënjestruara financiare sa i përket financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Për më tepër, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me vendimin Nr. Ref 360/2022 të datës 24/10/2022 ka formuar Grupin Punues Ndërinstitucional për Koordinimin e Zbatimit të Sanksioneve Ndërkombëtare.

Rekomandimi 3 – Vepra e pastrimit të parave

Sa i përket këtij rekomandimi duhet të theksohet mangësia e identifikuar lidhur me veprën penale të manipulimit të tregut e cila nuk mbulohet si një vepër penale kryesore e ndërlidhur me pastrimin e parave në Kodin Penal të Kosovës, andaj kjo edhe reflektohet në Ligjin për PPP/LFT. Po ashtu sa i përket përgjegjësisë penale të personave juridikë ka nevojën për harmonizim në mes të Ligjit për PPP/LFT dhe KP apo edhe Ligjit për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë për Vepra Penale në lidhje me standardin e dijenisë së aplikueshme në rast të veprave të PP-së.

Vepra penale e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e përshkruara në nenin 56 dhe 57 të Ligjit për PPP/LFT kanë qenë kompetencën ekskluzive e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, sipas Ligjit Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, që nënkupton se kjo Prokurori ka mbikëqyr të gjitha hetimet e PP-së që janë ndërmarr nga Autoritetet e Zbatimit të Ligjit.

Në lidhje me këtë Raporti i Vlerësimit i PECK-II ka gjetur se Kosova ka arritur vetëm një nivel të Moderuar të efektivitetit për AM.7 që nënkupton se karakteristikat e një sistemi efektiv për hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e PP-ve janë arritur vetëm deri në një shkallë dhe se nevojiten përmirësime. Performanca e moderuar e autoriteteve të Kosovës për të hetuar dhe ndjekur penalisht pastrimin e parave në mënyrë efektive në masë të madhe i është atribuar çështjeve që janë ndërlidhur direkt me performancën e PSRK-së.

Në Maj të vitit 2021 në kuadër të PECK III është përgatitur dokumenti teknik i titulluar “Rishqyrtimi i kompetencës ekskluzive të Prokurorisë Speciale mbi ndjekjen penale të pastrimit të parave” që paraqet një analizë të fushëveprimit dhe ushtrimit në praktikë të kompetencave ekskluzive që Prokuroria Speciale në Kosovë ka për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të Pastrimit të Parave (PP) në Kosovë.

Në pjesën hyrëse dokumenti bën një përmbledhje se ku dhe si kriminalizohet në legjislacionin e Kosovës vepra penale e pastrimit të parave dhe cilat Agjenci për Zbatimin e Ligjit dhe autoritete prokuroriale janë të përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të kësaj vepre penale. Pas kësaj, shtjellohen standardet përkatëse të FATF-së në këtë fushë, që në fakt nënkupton Rekomandimet

3, 30 dhe 31 si dhe Rezultati i Menjëhershëm 7 së bashku me përfundimet e përgjithshme që janë nxjerrë dhe gjetjet e bëra nga vlerësuesit e PECK-II lidhur me këto standarde. Një kapitull më vete nënvizon gjetjet e vlerësuesve në vitin 2018 lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale efektive të rasteve të PP-së, me vëmendje të posaçme tek analiza e statistikave penale dhe identifikimi i numrit të konsiderueshëm të lëndëve të grumbulluara në rastet e PP-së në PSRK.

Pastaj, ky dokument analizon edhe faktorët e ndryshëm që mund të kenë çuar drejt kësaj performace të PSRK-së në këtë fushë, përfshirë çështje me personelin, volumin e rritur të punës dhe faktorë të tjerë, si standardet shumë më të larta se zakonisht për prova që zbatohen nga PSRK-ja, si dhe paraqitet lista e veprimeve të rekomanduara që kryesisht përbëhet nga ndryshimi i pjesëve specifike të Ligjit për PPP/LFT dhe Ligjit për PSRK në mënyrë që të thjeshtohet dhe përafronet korniza ligjore ekzistuese dhe kështu të arrihen qëllimet që fillimisht janë përcaktuar nga RV i PECK II.

Si rezultat i kësaj situate ma datë 26 Tetor 2023 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin Nr.08/L-168 i shpallur me dekretin Nr. DL-181/2023, datë 15.11.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës. Ky ligj u publikua në Gazetën Zyrtare me datë 23 Nëntor 2023 dhe ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Si rrejdhiqje e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, në kornizën ligjore actual keni ndryshime sa i përket kompetencës së hetini të veprës penale të pastrimit të parave.

Sipas Ligjit Nr.08/L-168 Prokuroria Speciale ka kompetencë të veçantë lëndore mbi “veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, e cila ndërlidhet me kapitullin XIV të Kodit Penal, i cili përfshin veprat penale të ndërlidhura me terrorizmin.

Ndërsa sa i përket veprës penale të pastrimit të parave, Prokuroria Speciale ka juridiksion mbi veprën penale të pastrimit të parave të kryer së bashku me [të tjera] “vepra penale që janë në kompetencën e Prokurorisë Speciale, pavarësisht nga shuma apo përfitimi”. Ndërsa më tej, Prokuroria Speciale ka juridiksion edhe për veprën penale pastrimi i parave, të kryer “si një vepër e vetme penale, nëse vlera e shumës ose përfitimit është në shumën prej pesëqind mijë (500,000) Euro ose më shumë”.

Rekomandimi 4 – Konfiskimi dhe Masat e Përkohshme

Sipas vlerësuesve, përderisa korniza ligjore lidhur me konfiskimin dhe masat e përkohshme përputhet me shumicën e kriterëve, ekziston një numër i madh i kriterëve të cilët nuk janë plotësuar, përfshirë kërkesën për të identifikuar dhe gjurmuar pasuritë dhe kërkesën që mundëson ndërmarrjen e hapave për të parandaluar ose anuluar veprimet që dëmtojnë ngrirjen e pasurive ose konfiskimin ose rimarrjen e pronës që i nënshtrohet konfiskimit. Po ashtu sipas tyre është e paqartë se deri në cilin nivel është e mundur që të konfiskohen asetet e ndërlidhura me financimin e terroristeve ose organizatave terroriste pa ndonjë lidhje specifike me një akt terrorist. Për më tepër, ekziston një numër i procedurave në mospërputhje me njëra tjetrën për masat e përkohshme, gjë që krijon konfuzion në zbatimin e tyre praktik. Andaj, amendamentet ndaj legjislacionit relevant janë kërkuar të bëhen për të adresuar këto mangësi.

Autoritetet vendore me qëllim të adresimit të këtyre mangësive kanë ndërmarrë një sërë nismash për ndryshime legjislative të cilat kanë rezultuar në miratimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal të

Republikës së Kosovës, Kodit 08/L-032 për Procedurën Penale , si dhe Ligjin Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.

Lidhur me veprën penale të pastrimit të parave si të vetme në Kosovë, pas periudhës së vlerësimit nga ekspertët ka pasur dy raste të suksesshme, ku PSRK ka bërë hapa avancues në këtë drejtim. Kjo, dëshmohet me rastin PPS. Nr.37/17, të datës 28.12.2017 ku është ngritur aktakuzë për veprën penale të shpëlarjes së parave, në vete, pra, pa veprën penale bazë. Ky rast fiton vëmendje të posaçme pasi ka të bëjë me aktakuzë të ngritur vetëm me veprën penale të shpëlarjes së parave, në vete, pra, pa veprën penale bazë. Dhe, kjo është e rëndësishme dhe ka fituar edhe më shumë vëmendje nga shkak se ka pasur një rezistencë në të kaluarën, nëse mund të ngritet një aktakuzë e tillë pa veprën bazë penale.

Rasti tjetër ka të bëjë me aktakuzën e ngritur nga PSRK, nën referencën PPS. Nr. 33/2020, të datës 31.01.2022, ku është ngritur aktakuzë kundër një të pandehuri, P. K, për shkak të veprës penale, shpëlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5 dhe paragrafi 3 nën-paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Terrorizmit.

Ndërmarrja e masa sistematike për hetimin dhe ndjekjen penale në mënyrë autonome të veprës penale të pastrimit të parave, pa pasur nevojë për ndjekjen penale të veprave penale të ndërlidhura, në bazë të praktikës gjyqësore të kohëve të fundit duhet promovuar, si dhe nëse shihet e nevojshme qartësimi i definicioneve siç mund të jetë aktivitetit kriminal apo të tjera, përkundër faktit që ligji aktual në dispozita ndërthen dhe sqaron këto çështje, do të mund të rishikohen nëse ka nevojë për trajtim të mëtutjeshëm.

Rekomandimi 5 – Vepra e Financimit të Terrorizmit

Raporti i vlerësimit ka vërejtur probleme lidhur me kriminalizimin e dyfishtë të financimit të terrorizmit (TF); probleme lidhur me kriminalizimin e shkeljeve të ndryshme terroriste të përfshira në nëntë traktate në shtojcat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për FT për arsye të mos mbulimit të tërësishëm të gjitha këto shkelje si terrorizëm, kryesisht në lidhje me elementin e qëllimshëm dhe mungesën e kriminalizimit të tërësishëm për financimin e individëve të cilët iu bashkohen, marrin pjesë në zonat e konfliktit, shtojnë të tjerët dhe sigurojnë mbështetje logjistike (të cilat janë larguar nga fushëveprimi i shkeljes së FT. Raporti i vlerësimit vëren se drafti i ri i propozuar i Kodit Penal mban fushëveprimin e përkufizimit të terrorizmit, aktit terrorist ose shkeljes terroriste të Kodit Penal të tanishëm. Njëkohësisht, dispozita e propozuar për lehtësimin e terrorizmit, duke zgjeruar fushëveprimin e shkeljes (diskutuar më poshtë nën kriterin përkatës), ende nuk zgjidh mungesat e lartcekura. Prandaj, është e nevojshme që të sigurohet se ndryshimet e reja në Kodin Penal t'i adresojnë këto mungesa.

Kodi 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës në dispozitat e përcaktuara në nenet 114 -139 ka trajtuar çështjet e rekomanduara për përmirësim dhe tani përkufizimet me dispozitat e reja ligjore përfshijnë terrorizëm, veprim terrorist apo veprën terroriste, terroristin, grupin terrorist, grupin e strukturuar, fondet, dhe burimet financiare. Tutje, trajtohen edhe kryerja e veprës terroriste, ndihma në kryerjen e terrorizmit, lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit, rekrutimi për

terrorizëm, trajnimi për terrorizëm, shtytja për kryerjen e veprave terroriste, fshehja ose moslajmërimi i terroristëve apo grupeve terroriste, organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, udhëtimi për qëllime të terrorizmit, dhe përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës.

Rekomandimi 6 - Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit

Sipas standardeve ndërkombëtarë të Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF) mbi Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, konkretisht rekomandimi 6 përcakton sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, me ç' rast vendet duhet të zbatojnë sanksione financiare specifike, në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, që lidhen me parandalimin dhe goditjen e terrorizmit dhe financimit të tij. Rezolutat u kërkojnë vendeve që të ngrijnë pa vonesë fondet apo pasuritë e tjera dhe të sigurohen se fondet apo pasuritë e tjera nuk vihen në dispozicion, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorët, drejt ose në përfitim të cilit do person ose subjekt qoftë:

- i përcaktuar nga, ose nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nën Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë në përputhje me rezolutën 1267 (1999) dhe rezolutat pasardhëse të saj, ose
- i shpallur nga ai vend në përputhje me Rezolutën 1373 (2001).

Në Kosovë kjo çështje deri në një masë trajtohet me Ligjin Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtarë (ZSN), mirëpo ka pasur mangësi të caktuara në këtë drejtim, e veçanërisht përkitazi me sanksionet financiare që lidhen me terrorizmin, financimin e terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, që duhet të adresohen lidhur me ngrirjen e fondeve apo pasurive të tjera dhe- ndërmarrjen e masave - në lidhje me personat e shpallur nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara siç përcaktohet me rezoluta përkatëse.

Ligji për Sanksione Ndërkombëtare nuk ka përcaktuar një autoritet kompetent që është në gjendje të përcaktojë në mënyrë të menjëhershme nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, ose një bazë e arsyeshme për të dyshuar apo të besuar se një person apo entitet është një terrorist, organizatë terroriste apo person që ka lidhje me terroristët; fondet ose pasuritë e tjera që lidhen me terrorizmin t'i nënshtrohen menjëherë procesit të ngrirjes pas konstatimit se ekziston baza e tilla e arsyeshme; dhe ngrirja e fondeve dhe pasurive të tjera të kryhet pa njoftimin paraprak të palëve të përfshira.

Sipas dokumentit teknik për Opinion Ligjor mbi rishikimin e Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë të përgatitur nga ekspertë të Këshillit të Evropës⁴ në kuadër të Projektit PECK regjimi i Kosovës për zbatimin e Rekomandimit 6 të TFVF-së të vitit 2012 dhe Rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (RKSOKB) që kërkojnë nga vendet që të ngrijnë pa vonesë pasuritë terroriste dhe të ndalojnë që fondet dhe burimet e tjera (përfshirë shërbimet financiare) t'u vihen

⁴ Giuseppe Lombardo dhe Herbert Zammit LaFerla ECCU-PECK-eng-3/2015

në dispozicion personave dhe subjekteve të caktuara është jo i plotë dhe ka mos-pajtueshmëri me standardet në fjalë. Po ashtu raporti i vlerësimit nga PECK II i vitit 2018 konfirmon se Kosova është në mos-pajtueshmëri sa i përket rekomandimit 6 dhe 7 të TFVF-së. Ligji për ZNS vendos bazën për zbatimin e "sanksioneve ndërkombëtare", të përkufizuara si "kufizimet dhe detyrimet e caktuara me rezoluta, konventa, marrëveshje, deklarata apo çfarëdo akti të Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo ndonjë organizate tjetër ndërkombëtare" të natyrës ekonomike, financiare, politike, të komunikimit dhe publike (paragrafi (1.2) i nenit 2). Ndonëse nuk ka ndonjë referencë të veçantë për "ngrirjen" ose "ndalimin e ofrimit të fondeve ose pasurive të tjera në dobi të personave ose subjekteve të caktuara⁵", këto mund të përfshihen nga përkufizimi i "Sanksioneve Financiare" (paragrafi (1.4) i nenit 2 të Ligji për ZSN): "kufizimet e të drejtave të subjekteve, ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare, për të menaxhuar, përdorur apo disponuar paratë e gatshme, letrat me vlerë, mallrat, pasuri të tjera dhe të drejta pronësore; kufizimet e pagesave për subjektet kundër të cilave zbatohen sanksione ndërkombëtare; kufizime të tjera mbi aktivitetet financiare". Sidoqoftë, sipas këtij Opinion Ligjor, ekzistojnë disa probleme me Ligjin për ZSN, ndër të tjera:

- Ligji për ZSN mbështetet në një vendim të Qeverisë për zbatimin e tij, i cili nuk është nxjerr;
- Atij i mungon një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim në bazë të kriterëve të përcaktimit të përcaktuara në rezolutat e Kombeve të Bashkuara të Këshillit të Sigurimit (UNSCR - 1267/2001 dhe rezolutat e saj pasardhëse) dhe për të bërë kërkesa për listime të personave dhe subjekteve tek komiteti kompetent për sanksione në kuadër të OKB-së;
- Ajo nuk ofron një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim, bazuar në kriteret e përcaktimit të përcaktuara në Rezolutën 1373/2001, si dhe për përcaktimin e tyre në pajtim me këtë Rezolutë.
- Ai nuk parashikon autoritet apo mekanizme dhe procedura për të shqyrtuar dhe dhënë fuqi veprimeve të filluara sipas mekanizmave të ngrirjes të vendeve të tjera pajtim me Rezolutën 1373;
- Nuk është e qartë se "sanksionet financiare" do të mbulojë të gjitha rastet e parashikuara nga TFVF.

Në mungesë të këtyre dispozitave ligjore në kuadër të Ligjit për ZSN institucionet e zbatimit të Ligjit nuk kanë në dispozicion mekanizmin e ngrirjes pa vonesë të fondet apo pasuritë e tjera siç përcaktohet me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të cilat janë kërkesa që duhet trajtuar në mënyrë të ndryshme nga mënyra konvencionale e cila është e përcaktuar me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Andaj, duke pasur parasysh që mënyra e ngrirjes pa vonesë e fondeve apo pasurive tjera siç përcaktohet me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nuk është e përcaktuar me Ligjin për ZNS, kjo paraqat vështërsi në zbatimin e tij.

Lidhur me këtë çështje dhe adresimin e rekomandimit 6 dhe 7 të TFVF-së, Ministria përgjegjëse për Punë të Jashtme ka hartuar Koncept Dokumentin për përafrimin e kornizës ligjore vendore për sanksionet ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe pas

⁵ Fjalorth i Rekomandimeve të TFVF-së, përkufizimi i "sanksioneve të shënjestruara financiare".

aprovimit të këtij koncept Dokumenti ka krijuar grupin punues për hartimin e ligjit për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara. Autoritetet vendore me qëllim të adresimit të këtij rekomandimi kanë miratuar Ligji Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare Financiare të Shënjestruara i cili ka sjell ndryshime e nevojshme për të adresuar rekomandimin dhe zbatuar sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit. Për më tepër, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me vendimin Nr. Ref 360/2022 të datës 24/10/2022 ka formuar Grupin Punues Ndërinstitucional për Koordinimin e Zbatimit të Sanksioneve Ndërkombëtare.

Me këtë ligj rregullohet mënyra e listimit, zbatimi dhe delistimi i personave të përcaktuar lidhur me sanksionet financiare ndërkombëtare të shënjestruara në Republikën e Kosovës dhe që kanë të bëjnë me zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare financiare të shënjestruara lidhur me luftën kundër terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, zhvillimin dhe forcimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe arritjes së objektivave të tjera në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, sipas Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të miratuara në bazë të Kapitullit VII të OKB-së, aktet e Bashkimit Evropian, vendimet e organizatave të tjera ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është anëtare ose që i zbaton ato, si dhe në baza tjera në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Ligji përmban dispozitat e përgjithshme që kanë të bëjnë me qëllimin, fushëveprimin dhe përkufizimet, trajton listat e personave të përcaktuar dhe procedurat e përcaktimit.

Lista e konsoliduar e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (KSOKB) publikohet në ueb faqen e NjIF-K, pa vonesë, e cila pastaj menjëherë për çfarëdo ndryshimi të bërë në listë njofton autoritetet kompetente të përcaktuar në ligj, si dhe subjektet raportuese dhe institucionet tjera që vlerësohet e nevojshme të informohen.

Po ashtu trajtohet çështja sa i përket propozimeve të autoriteteve shtetërore për përcaktimin e personave në listën vendore, propozimi për delistim i personave të përcaktuar në listat e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe personave të përcaktuar në listat vendore.

Kërkesat për raportim të drejtpërdrejtë, ku personave raportues u kërkohet të kenë dhe të zbatojnë politikatat dhe procedurat për të përcaktuar nëse klientët e tyre janë persona të përcaktuar. Nëse subjekti raportues e verifikon se ka marrëdhënie biznesi me një person të përcaktuar, ai duhet t'i ngrijë asetet e personit të përcaktuar menjëherë dhe pa njoftim paraprak apo udhëzim ligjor nga një autoritet kompetent apo nga gjykata, menjëherë të raportojë hollësitë e veprimit në NjIF-K. Asetet që do të ngrihen sipas paragrafit 2 të këtij neni nuk përfshijnë vetëm asetet që janë pronë e drejtpërdrejtë ose të kontrolluara nga personi ose subjekti i përcaktuar, por gjithashtu ato fonde ose mjete të tjera që janë tërësisht ose në mënyrë të përbashkët ose të kontrolluara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga personi apo subjekti i përcaktuar.

NjIF-K rregullon mënyrën e raportimit të referuar në tek kërkesat për raportim të drejtpërdrejtë.

Po ashtu trajtohet ndalesat e vënies në dispozicion dhe ngrirja e aseteve, revokimi i vendimit për ngrirjen e aseteve. Ligji trajton edhe procedurën gjyqësore ndaj vendimeve për listim, përcakton ndëshkimet për shkeljet dhe kompetencën e mbikëqyrjes për MPJ, autoritetet e tjera dhe NjIF-K.

Rekomandimi 7 - Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me përhapjen

Rekomandimi 7 i TFVF-së ka të bëjë me sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Sipas këtij rekomandimi vendet duhet të zbatojnë sanksione specifike financiare në përputhje me Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me parandalimin, goditjen, shtypjen dhe pengimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe financimin e tyre. Këto rezoluta u kërkojnë vendeve të ngrijnë pa vonesë fondet apo pasuritë e tjera dhe të sigurohen se nuk ka fonde apo pasuri të tjera në dispozicion, drejtpërdrejt ose indirekt, drejt ose në përfitim të, cilitdo person ose subjekt të shpallur nga këto Rezoluta, ose nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Lidhur me këtë çështje dhe adresimin e rekomandimit 7 të TFVF-së, Ministria përgjegjëse për Punë të Jashtme ka hartuar Koncept Dokumentin për përafrimin e kornizës ligjore vendore për sanksionet ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe pas aprovimit të këtij koncept Dokumenti ka krijuar grupin punues për hartimin e ligjit për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara, ku ky ligj pritet të shpejti të dërgohet për aprovim në Qeveri dhe pastaj miratim në Kuvend, me ç'rast do të harmonizohet kjo fushë me standardet ndërkombëtare të TFVF-së dhe BE-së.

Autoritetet vendore me qëllim të adresimit të këtij rekomandimi kanë miratuar Ligji Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare Financiare të Shënjestruara i cili ka sjell ndryshime e nevojshme për të adresuar rekomandimin dhe zbatuar sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me përhapjen. Për më tepër, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me vendimin Nr. Ref 360/2022 të datës 24/10/2022 ka formuar Grupin Punues Ndërinstitucional për Koordinimin e Zbatimit të Sanksioneve Ndërkombëtare.

Me këtë ligj rregullohet mënyra e listimit, zbatimi dhe delistimi i personave të përcaktuar lidhur me sanksionet financiare ndërkombëtare të shënjestruara në Republikën e Kosovës dhe që kanë të bëjnë me zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare financiare të shënjestruara lidhur me luftën kundër terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, zhvillimin dhe forcimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe arritjes së objektivave të tjera në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, sipas Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të miratuara në bazë të Kapitullit VII të OKB-së, aktet e Bashkimit Evropian, vendimet e organizatave të tjera ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është anëtare ose që i zbaton ato, si dhe në baza tjera në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Për më shumë qartësi rreth dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare Financiare të Shënjestruara është dhënë sqarimi tek Rekomandimi 6 më lartë në këtë dokumenti dhe e njëjta vlen edhe për këtë Rekomandim.

Rekomandimi 8 – Organizatat Jofitimprurëse (OJF)

Rekomandimi 8 i FATF i nxit shtetet që të rishikojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve për t'u siguruar që OJQ-të nuk mund të keqpërdoren nga organizatat terroriste që paraqiten si

subjekte të ligjshme; për të shfrytëzuar subjektet e ligjshme si kanale për financim të terrorizmit, duke përfshirë edhe synimet për t'iu shmangur masave të ngrirjes së pasurisë; dhe për të fshehur ose larguar vëmendjen nga ndryshimi i destinimit të fondeve të përcaktuara për qëllime të ligjshme tek organizatat terroriste.

Lidhur me obligimet ligjore të OJQ-ve në Kosovë sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, grupi punues do të veprojë në harmoni me kërkesat e rekomandimit 8 të FATF dhe raportin e vlerësimit të rrezikut kombëtarë dhe vlerësimet sektoriale për këtë fushë dhe do të përcaktojë se deri në çfarë niveli mungesat e identifikuar nga raportet e vlerësimit janë ende relevante sa i përket ndryshimeve të bëra nga FATF tek Rekomandimi 8.

Sa i përket rreziqeve për financimit të terrorizmit në sektorin e OJF-ve, kemi një vlerësim të përfunduar në nivelin regjional dhe një vlerësim të iniciuar në nivelin vendor.

Në nivelin regjional nëpërmjet një Programi të Përbashkët të Këshillit të Evropës "Horizontal Facility for the Western Balkans and Türkiye" është hartuar një Dokument Teknik⁶ ku është paraqitur Vlerësimi i Rrezikut në Nivel Regjional në Sektorin e Organizatave Jo Fitimprurëse në Ballkanin Perëndimorë dhe Turqinë 2020/2021.

Sipas këtij Dokumenti rezultatet përfundimtare të faktorëve të rrezikut rajonal tregojnë se rreziqet e FT në sektorin e OJF-ve të rajonit janë të përqendruara vetëm në disa fusha kyçe, pavarësisht se janë identifikuar shumë faktorë rreziku me dimension rajonal. OJF-të fetare/etnike/kulturore dhe financimi i OJF-ve të huaja nga juridiksione me rrezik të lartë ose burime të paverifikueshme përfaqësojnë zonat kryesore të rrezikut për rajonin, me analizën që jep besim të fortë se të dyja paraqesin një rrezik shumë të lartë.

Më tej, është vërejtur se OJF-të humanitare, bamirëse dhe ndihmuese paraqesin një rrezik të dukshëm, por pak më pak të rëndësishëm për financimin e terrorizmit për rajonin. Ndërsa analiza jep siguri se ka një rrezik më të ulët të financimit të terrorizmit ku OJF-të në rajon financohen nga komunitetet e diasporës.

Tutje, në nivelin vendor është duke u zhvilluar vlerësimi i rreziqeve të këtij sektori për FT dhe Njësia për Inteligjencë Financiare si bartëse e këtij procesi me Vendimin FIUAD: 73/2023 i datë 14/02/2023 ka formuar grupin Punues për Vlerësimin e Rrezikut Sektorial të financimit të terrorizmit dhe veprave të ndërlidhura në Sektorin e Organizatave Jo Qeveritare/ Jo Fitimprurëse i cili grup do të analizoj, vlerësoj dhe hartoj raportin mbi rreziqet në këtë sektorin e OJF-ve.

Rekomandimi 9 – Ligjet e fshehtësisë për institucionet financiare

Kosova në këtë pikë është vlerësuar se është kryesisht në përputhje me rekomandimin 9, andaj në kuadër të dispozitave ligjore nuk rekomandohet ndonjë veprim shtesë. Sa i përket kësaj pike mund adresohet rekomandimi që të fuqizohet dispozita sa i përket informacionit të nevojshëm për analizën strategjike të PPP/LFT-së të kryer nga NjIF-K që të mund të sigurohet nga autoritetet e tjera siç rekomandohet nga raporti i vlerësimit 2018 .

Rekomandimi 10 - Kujdesi i duhur ndaj klientit

⁶ <https://rm.coe.int/npo-rra-final-amended-250822-publishing/1680a7fb07>

Raporti i vlerësimit vëren një numër të çështjeve lidhur me këtë Rekomandim, të cilat janë të paraqitura më poshtë të ndara sipas temës të cilës i ndërlidhen dhe me shenjen të mjetit ligjor i cili do duhej të ndryshohet (të dyja të shënuara për të lehtësuar referencën). Metodologjia e FATF ka bërë të qartë se shumica e këtyre kërkesave mund të zbatohen përmes legjislacionit dytësor ose mjeteve të tjera të zbatueshme. Përderisa këto mjete, në parim, që korrigjojnë këto mungesa me legjislacionin dytësor, mund të ishin të mjaftueshme, duhet kuptuar kornizën specifike të Kosovës, ku kërkesat e Kujdesit të duhur ndaj klientit (KDK) janë specifikisht të rregulluara brenda ligjit për PPP/LFT prandaj mundësia për të futur kërkesa të reja përmes legjislacionit dytësor mund të jetë e kufizuar.

Kur kërkohet KDK

Ligji i PPP/LFT nuk iu kërkon bankave dhe institucioneve të tjera financiare që të ndërmarrin të gjitha masat e zbatueshme lidhur me kujdesin e duhur ndaj klientit (e kundërta nga vetëm identifikimi i klientit dhe verifikimi i identitetit) në rast të : a) transaksionet e rastit mbi pragun e përcaktuar të 10 000 EUR të cilat nuk kryhen me kesh dhe b) transaksionet të cilat bëhen me transfer dhe kryhen përmes institucioneve të tjera përveç bankave.

Amendamenti i propozuar

Amendamenti i ligjit për PPP/LFT (paragrafi 2 i nenit 19)

Masat e KDK-së të kërkuara për të gjithë klientët:

- i)* Kërkesa për të përdorur dokumente, të dhëna ose informacione burimore të besueshme dhe të pavarura nuk është e përkufizuar qartë.
- ii)* Kërkesa për të verifikuar autorizimin e çfarëdo personi që pretendon të veproj në emër të klientit nuk mbulon situata ku subjektet raportues:
 - a)* angazhohet në marrëdhënie me personat të cilët veprojnë në emër të klientit jashtë fushëveprimit të kryerjes së transaksioneve; dhe
 - b)* merren me persona juridikë të tjera përveç organizata buxhetore, OJQ ose subjekte politike si dhe me marrëveshje ligjore;
- iii)* dispozita për vendosjen e pronësisë përfitues dështon në lidhje me kërkesën për subjektet raportuese për të:
 - a)* përdorur informacione ose të dhëna përkatëse nga një burim të besueshëm kur merren masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues dhe
 - b)* marrë masa të tilla në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen me rrezik të lartë;

- iv) dispozita për vendosjen e pronësisë përfituese dështon në lidhje me kërkesën për subjektet raportuese për të:

Veprimet/amendamentet e propozuara janë paraqitur në vijim:

Amendamenti i propozuar

- Hartimi i një udhëzuesi për Kujdes të Duhur ndaj Klientit;
- Ndryshim-plotësim i Ligjit për PPP/LFT: Paragrafi 7 i nenit 19 dhe të tjerat.

Masat specifike të KDK-së të kërkuara për personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore:

- i) Subjekteve raportuese nuk ju kërkohet të kuptojnë pronësinë dhe strukturën kontrolluese të klientëve në situatat jashtë atyre që konsiderohen me rrezik të lartë;
- ii) Nuk ka kërkesë për të marrë informacione lidhur me vendin kryesor të biznesit të një personi ose marrëveshje juridike nëse është e ndryshme nga adresa e zyrës së regjistruar;
- iii) Nuk ka kërkesë për të vendosur identitetin e personit fizik përkatës, i cili mban pozitën e zyrtarit të lartë menaxhues, në raste kur asnjë person fizik nuk është identifikuar sipas përkufizimit të pronarit përfitues;
- iv) Përfituesit e marrëveshjeve ligjore të identifikuar nga disa karakteristika nuk janë të përcaktuar si pronarë përfitues.

Amendamenti i propozuar:

- *Ndryshim-plotësim i ligjit për PPP/LFT: Paragrafi 2 i nenit 19, paragrafët 3.2 dhe 4 të nenit 19, etj.*

Lidhur me masat specifike të KDK-së të kërkuara për personat juridik dhe marrëveshjet ligjore NjIF-K për të adresuar çështjet e ngritura më sipër NjIF-K ka hartuar Udhëzimi Administrativ MF (NjIF-K) 01/2021 për Pronarin Përfitues për Subjektet Raportuese. Megjithatë edhe ndryshim-plotësim i ligjit për PPP/LFT tek paragrafi 2 i nenit 19, paragrafët 3.2 dhe 4 të nenit 19 mbeten relevant dhe i nevojshëm me qëllim të adresimit të ë të këtij rekomandimi. Ndërsa çështja e pronësisë përfituese është duke vazhduar të adresohet edhe me Projektligjin për Pronësinë Përfituese.

KDK për përfituesit e polisave të sigurimit të jetës

- i) Dispozitat për përfituesit e polisave të sigurimit të jetës nuk kërkojnë nga subjektet raportuese që të:
 - a) ndërmarrin veprimet përkatëse, sapo të jetë identifikuar apo përcaktuar përfituesi; dhe
 - b) kur përfituesi është identifikuar si marrëveshje ligjore e emëruar, të regjistrohet emri i marrëveshjes,
- ii) subjekteve raportuese nuk iu kërkohet të përfshijnë përfituesin e një polise të sigurimit të jetës si një faktor të rëndësishëm rreziku përkatës në përcaktimin nëse masat e KDK-së së shtuar janë të zbatueshme.

Amendamenti i propozuar:

Ndryshim-plotësim i ligjit për PPP/LFT

Koha e verifikimit

- i) Në situata të tjera nga ato që konsiderohen si me rrezik të lartë, kërkesa për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues para ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së transaksioneve për klientë të rastit nuk është vendosur;
- ii) Subjekteve raportuese nuk iu kërkohet që të miratojnë procedurat e menaxhimit të rrezikut lidhur me kushtet nën të cilat një klient mund të përdorë marrëdhënien e biznesit para verifikimit.

Amendamenti i propozuar

Ndryshim-plotësim i ligjit për PPP/LFT

Klientët ekzistues

Nuk ka kërkesë për të kryer KDK-në në klientët ekzistues duke marrë parasysh nëse dhe kur masat e KDK-së janë ndërmarrë më herët dhe përputhshmëria e të dhënave të marra.

Amendamenti i propozuar

Ndryshim-plotësim i ligjit për PPP/LFT ose rishikim i Rregullores së Bankës Qendrore për PPP/LFT.

Qasja e bazuar në rrezik:

- i) Kërkesa për të kryer KDK aty ku rreziqet e PP/FT janë më të mëdha nuk janë të përkufizuara qartë;
- ii) Elementet dhe parakushtet për të lejuar një KDK të thjeshtuar nuk janë të përkufizuara qartë.

Amendamenti i propozuar

Ndryshim-plotësim i ligjit për PPP/LFT ose rishikim i Rregullores së Bankës Qendrore për PPP/LFT lidhur me qasjen e bazuar në rrezik.

Dështimi në plotësimin e kënaqshëm të KDK-së

Nuk ka kërkesa të qarta lidhur me subjektet raportuese që të mos hapin llogarinë, marrëdhënie biznesi tregtare ose të kryejnë transaksionin, ose të përfundojnë marrëdhënien e biznesit kurdo që nuk kanë mundësi të përputhen me të gjitha masat përkatëse të KDK-së

Amendamenti i propozuar

Ndryshim-plotësim i ligjit për PPP/LFT lidhur me plotësimin e pakënaqshëm të KDK-së

KDK dhe zbulimi

Dispozitat që parandalojnë zbulimin e klientëve nuk janë në dispozicion. Legjislacioni i zbatueshëm nuk fakton që, në raste ku subjektet raportuese vendosin një dyshim të PP/FT dhe besojnë arsyeshëm që kryerja e procedurës së KDK-së do të zbulojë klientin, do të duhej t’ju lejohet që të mos vijojnë me procedurën e KDK-së dhe në vend të tij t’ju kërkohen të plotësojnë në RTD.

Amendamenti i propozuar

Ndryshim-plotësim i ligjit për PPP/LFT për KDK dhe nxjerrjen e informacioneve

Është e rëndësishme të vërehet se Direktiva e 5-të ka zgjeruar ndalimin e mbajtjes së llogarive anonime dhe librezave (ekzistonte në legjislacionin e Kosovës) po ashtu të kasafortave anonime, të cilat mund të kërkojnë ndryshim legjislativ.

Përdorimi i teknologjive të raja për procesin e identifikimit dhe verifikimit me qëllim të marrjes së të dhënave adekuate dhe të sakta për identifikimin e klientëve duhet promovuar, bazuar edhe në kornizën aktuale ligjore dhe standardet ndërkombëtare të fushës të cilat kanë avancuar.

Rekomandimi 11 - Ruajtja e të dhënave

Sa i përket rekomandimit 11 Kosova është kryesisht në përputhje, ajo çfarë rekomandohet lidhur me arritjen e pajtueshmërisë së plotë është lidhur me kriterin (11.2) ka të bëjë me zgjerimin e fushëveprimit të nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT ku subjekteve raportuese përveç që u kërkohet që të mbajnë të gjitha të dhënat e marra përmes masave të KDK-së, të mbajnë dhe çdo analize të ndërmarrë në lidhje me transaksionet e rastit, përveç atyre të përcaktuara me nenin 25 të Ligjit për PPP/LFT (për sa kohë që periudha e mbajtjes është e përcaktuar “për së paku 5 vjetët e fundit pas përfundimit të marrëdhënies biznesore”).

Rekomandimi 12 – Personat e ekspozuar politikisht

Me qëllim arritjes së pajtueshmërisë me këtë rekomandim në Ligjin për PPP/LFT duhet definuar obligimin sipas kriterit (12.1) ku subjekteve raportuese duhet të i’u kërkohet të vendosin sisteme të menaxhimit të rrezikut për të përcaktuar nëse një klient ose një pronar përfitues është PEP. Kjo mund të adresohet përmes një amendamenti të Ligjit PPP/LFT ose nga legjislacioni dytësor. Të qartësohet shtrirjen dhe mbulimi i masave që duhet të zbatohen në lidhje me anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë të PEP-ëve sipas kriterit (12.3); dhe të parashihet që përcaktimi nëse përfituesi dhe/ose, kur është e nevojshme, pronari përfitues i përfituesit është PEP duhet të ndodhë, më së voni, në kohën e pagesës (kriteri 12.4) përmes legjislacionit dytësor ose udhëzimeve detyruese

Rekomandimi 13 – Banka korrespondente

Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 13, për këtë rekomandim (kriteri 13.1 dhe kriteri 13.2) kërkohet që në ligjin për PPP/LFT të mbulohen edhe marrëdhëniet ndërmjet

institucioneve të tjera financiare jo vetëm bankat, si dhe tek përkufizimi i bankës guaskë të trajtohen edhe disa elemente të caktuara të përkufizimit të FATF-së (kriteri 13.3) domethënë mungesën e pranisë fizike në vendin në të cilin banka është e licencuar (në krahasim me atë që vetëm është inkorporuar) dhe mungesën e lidhjes me një grup financiar të rregulluar i cili është subjekt i mbikëqyrjes efektive të konsoliduar (në krahasim me detyrimin për mbikëqyrje joefektive dhe/ose të pa konsoliduar).

Rekomandimi 14 – Shërbimet e transferimit të parave apo valutës

Lidhur me këtë rekomandim Kosova është në përputhje, pasi të gjitha kriteret që përcaktojnë kërkesat në lidhje me shërbimet e transferimit të parave ose vlerave janë përmbushur, andaj nuk ka nevojë për ndonjë ndryshim.

Rekomandimi 15 – Teknologjitë e reja

Po ashtu për rekomandimin 15 Kosova ishte vlerësuar në përputhje. Mirëpo që nga vlerësimi i PECK-II në lidhje me PPP/LFT, FATF ka ndryshuar Rekomandimin 15.

Në tetor 2018, Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) përditësoi Rekomandimet e saj kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT) për të shtrirë kërkesat e tyre për asetet virtuale (VA) dhe ofruesit e shërbimeve të aseteve virtuale (VASP). Kjo përfshinte ndryshime në kërkesat ekzistuese të Rekomandimit 15 (R.15). Në qershor 2019, FATF miratoi një shënim interpretues për Rekomandimin 15 (INR.15) për të sqaruar se si kërkesat e R. 15 do të zbatoheshin për VA-të dhe VASP-të.

R.15, i ndryshuar, tani kërkon që VASP-të të rregullohen për qëllime LPP/LFT, të licencohen ose regjistrohen dhe t'i nënshtrohen sistemeve efektive për monitorim ose mbikëqyrje. Duhet të plotësohen kërkesa shtesë në lidhje me reagimin mbikëqyrës ndaj mospërputhjes (d.m.th., aplikimin e sanksioneve), zbulimin e aktivitetit të paautorizuar dhe masat e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me VA dhe VASP.

Në vitin 2020, FATF publikoi udhëzuesin për aplikimin e një qasjeje të bazuar në rrezik për rregulloren e LPP/LFT të VA-ve dhe VASP-ve. Ky udhëzues shqyrtoi rekomandimet e FATF për LPP/LFT pasi ato do të zbatoheshin për VA-të dhe VASP-të. Udhëzimi identifikon rreziqet e krimit financiar dhe ofron rekomandime për mbikëqyrjen dhe mbikëqyrjen e MV-ve dhe VASP-ve. Si pasojë, ky udhëzues u përditësua në tetor 2021 (Udhëzuesi FATF).

Në maj 2023, Forumi Ekonomik Botëror publikoi një raport në lidhje me nevojat dhe sfidat në zhvillimin e një qasjeje globale për rregullimin e krypto-aseteve. Raporti merr në konsideratë qasjet e ndryshme rregullatore që miratohen nga juridiksione të ndryshme dhe sfidat e hasura në mbikëqyrjen efektive të VA-ve dhe VASP-ve.

Në nivel të Bashkimit Evropian, udhëzimi i FATF-së për VA-të dhe VASP-të u plotësua me miratimin e Direktivës së 5-të Kundër Pastrimit të Parave. Kjo Direktivë kërkon që Shtetet Anëtare të mbikëqyrin përdorimin dhe promovimin e VA-ve dhe VASP-ve.

Në Bashkimin Evropian (BE), mbikëqyrësit e shteteve anëtare pritët të sigurojnë se kanë procedura dhe procese për miratimin dhe mbikëqyrjen e VASP-ve. Kjo përfshin njohjen dhe kërkesën për regjistrimin e VASP-ve ekzistuese, sigurimin që VASP-të e rinj të përfundojnë procesin e kërkuar të autorizimit dhe VASP-të e paautorizuara dhe aktivitetet e lidhura me VA-në të zbulohen dhe parandalohen.

Më 31 maj 2023, Autoriteti Bankar Evropian filloi konsultimin e tij mbi udhëzimet e reja për institucionet financiare dhe VASP-të mbi zbatimin e kërkesave Direktivës së 5-të Kundër Pastrimit të Parave.

Në nivelin e vendit, Kosova ka filluar përpjekjet e saj për rregullimin re VA-ve dhe VASP-ve me përgatitjen e projektligjit në vitin 2022. Një Grup Punues Parlamentar (PWG) është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe sponsorizimin e hartimit të Projektligjit për shqyrtim më vonë nga Parlamenti. GPP mbështet zhvillimin e mëtejshëm të Projektligjit dhe qëllimi është finalizimi i projektligjit në mënyrë që ai të reflektojë një ekuilibër të arsyeshëm ndërmjet mbështetjes së inovacionit të përgjegjshëm dhe parandalimit efektiv të krimit financiar.

Gjithashtu në përgjithësi, përdorimi i zgjidhjeve teknologjike për analizimin e avancuar të të dhënave që ndihmojnë në identifikimin më efektiv të tipologjive dhe transaksioneve të dyshimta duhet promovuar, dhe aty ku është e nevojshme dhe mundshme edhe aplikuar.

Rekomandimi 16 – Transfertat elektronike

Lidhur me transferet elektronike në kuadër të legjislacionit në fuqi nga Raporti i Vlerësimit për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtarë janë identifikuar disa mangësi.

Dispozitat për transferet elektronike (kriteri 16.1) nuk kërkojnë që:

a) numri i llogarisë së iniciuesit që shoqëron transfertën elektronike është veçanërisht numri i llogarisë që përdoret për të procesuar transaksionin;

b) në mungesë të një llogarie iniciuese, numri unik i referimit:

b.1) është ai i transaksionit specifik;

b.2) është ai që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit; dhe

c) në mungesë të një llogarie përfituese dhe kur numri i llogarisë së iniciuesit përdoret për të procesuar transaksionin, një numër referimi unik i transaksionit që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit shoqëron transfertën elektronike;

Të njëjtat mangësi janë relevante në lidhje me rregullimin e transfertave në grumbull dosjesh (batch file transfers) (kriteri 16.2);

Informacioni i iniciuesit për transfertat e brendshme elektronike duhet të kërkohet që të vihet në dispozicion edhe të autoriteteve të tjera përkatëse dhe mangësitë e identifikuar në analizën për kriterin 16.1 janë të rëndësishme për transfertat e brendshme elektronike (kriteri 16.5);

Institucioneve financiare urdhëruese duhet t'u kërkohet të ruajnë informacionin e mbledhur të përfituesit, në përputhje me Rekomandimin 11 (kriteri 16.7) dhe të ndalohej ekzekutimi i transfertës bankare nëse nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të specifikuar në kriteret 16.1 deri në 16.7 (kriteri 16.8);

Mangësitë e identifikuar në analizën për kriterin 16.1 janë të rëndësishme në lidhje me institucionet financiare ndërmjetëse në transfertat elektronike ndërkufitare (kriteri 16.9);

Institucioneve financiare ndërmjetëse duhet t'u kërkohet që të marrin masa të arsyeshme, të cilat janë në përputhje me përpunimin e drejtpërdrejtë, për të identifikuar transfertat elektronike ndërkufitare që nuk përmbajnë informacionin e kërkuar për iniciuesin apo informacionin e kërkuar për përfituesin (kriteri 16.11) dhe të kenë politika dhe procedura të bazuara në rrezik, për të përcaktuar:

- a) kur duhet të ekzekutojnë, refuzojnë ose pezullojnë një transfertë elektronike, e cila nuk përmban informacionet e kërkuara për iniciuesin ose përfituesin; dhe
- b) veprimet e duhura përcjellëse (kriteri 16.12);

Institucioneve financiare përfituese duhet t'u kërkohet të marrin masa të arsyeshme për të identifikuar transfertat elektronike ndërkufitare të cilat nuk kanë informacionin e kërkuar për përfituesin (kriteri 16.13) të ruajnë informacionet e verifikuara për identitetin e përfituesit në përputhje me Rekomandimin 11 (kriteri 16.14); dhe të kenë politika dhe procedura të bazuara në rrezik, për të përcaktuar: a) kur duhet të ekzekutojnë, refuzojnë ose pezullojnë një transfertë elektronike, e cila nuk përmban informacionet e kërkuara për përfituesin; dhe b) veprimet e duhura përcjellëse (kriteri 16.15);

Bankat dhe institucionet e tjera financiare që kontrollojnë si anën urdhëruese ashtu edhe atë përfituese të një transferte elektronike duhet të:

- a) të marrin parasysh të gjitha informatat nga pala përfituese; dhe
- b) të paraqesin një RTD në secilin vend të prekur nga transfertat elektronike e dyshimtë (kriteri 16.17); dhe

Legjislacioni në fuqi nuk kërkon që bankat dhe institucionet e tjera financiare të ndërmarrin veprime të ngrirjes dhe të veprojnë në përputhje me ndalimet nga kryerja e transaksioneve për personat dhe subjektet e përcaktuara në kontekstin e transfertave elektronike, sipas detyrimeve të përcaktuara në RKSKB-të lidhur me parandalimin dhe shtypjen e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit (kriteri 16.18), andaj ky rekomandim tani nuk qëndron pasi që është adresuar me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare Financiare të Shënjestruara i cili ka sjell ndryshime e nevojshme

Në nivel të Bashkimit Evropian, Direktiva e 5-të kundër Pastrimit të Parave sa i përket parave elektronike ka paraparë që:

- i. Në fakt, transaksionet maksimale të pagesës mujore për “remote payment” për kartelat e parapaguara anonime me qëllim të përgjithshëm, janë zvogëluar nga 250 në 150 €. Për më tepër, shuma maksimale e parave të depozituara në kartela të tilla nuk do të tejkalojë këtë prag.
- ii. Dhënia e anonimitetit për produktet e parave elektronike do të jetë e mundur vetëm në dy situata:
 - a. kur klientët përdorin instrumentin e tyre të parapagimit direkt në dyqan në vlerë jo më të madhe se 150 EUR;
 - b. kur klientët kryejnë një transaksion në internet me një kartelë parapagimi në vlerën jo më të madhe se 50 EUR.

Rekomandimi 17 – Mbështetja te palët e treta

Legjislacioni në fuqi është i heshtur në lidhje me mbështetjen te institucionet financiare dhe BPCJF-të të palëve të treta për të kryer elemente të caktuara të masave të KDK-së (identifikimi i klientit, identifikimi i pronarit përfitues dhe të kuptuarit e natyrës së biznesit) ose për prezantimin e biznesit. Kjo do të thotë që një mbështetje e tillë, edhe pse nuk lejohet në mënyrë të qartë, as nuk është e ndaluar në mënyrë specifike në Kosovë. Në praktikë nuk ka ndodhur një mbështetje e tillë, pasi që ligji në mënyrë specifike nuk rregullon mbështetjen e tillë dhe është zbatuar sikurse është e ndaluar, megjithatë, lidhur me adresimin e kësaj mos pajtueshmërie çështja e mbështetjes tek palët e treta duhet që specifikisht në mënyrë të shprehur të përcaktohet me ligji. Nga vendet në rajon një pjesë e madhe e kanë të ndaluar këtë mbështetje si shembull është legjislacioni i Shqipërisë apo kemi edhe praktika të cilat e kanë pasur të lejuar dhe me ndryshimet ligjore e kanë ndaluar apo kufizuar mbështetjen tek palët e treta, siç është rasti me legjislacionin e Bullgarisë. Paragrafi 5 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT, bankat dhe institucionet financiare zbatojnë programe në kuadër të grupit që mbulojnë degët e tyre të huaja dhe filialet, në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë, kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë politikat dhe procedurat për shkëmbimin e informatave brenda grupit për qëllime të këtij ligji, andaj, kjo siguron pajtueshmëri të pjesshme me kriterin 17.3 ndërsa elementet tjera të këtij rekomandimi duhet trajtuar me kujdes.

Grupi Punues konsideron se mbështetje tek palët e treta nuk duhet lejuar në Kosovë.

Rekomandimi 18 – Kontrollat e brendshme dhe degët e filialet e huaja

Me qëllim të eliminimit të mos pajtueshmërive teknike duhet të ketë dispozita ligjore tek neni 17 i Ligjit për PPP/LFT-në ku kërkohet që në programet e subjekteve raportuese kundër PP/FT-së të konsiderohen edhe rreziqet e PP/FT dhe madhësinë e biznesit. Tutje tek neni 21 i ligji për PPP/LFT funksioni i pajtueshmërisë për bankat kërkohet të udhëhiqet nga një menaxher i lartë dhe të jetë i pavarur nga të gjitha funksionet e tjera të subjektit raportues dhe për subjektet tjera raportuese me kusht që të ketë kapacitete të mjaftueshme administrative për këtë, ndërsa sipas standardit për të gjitha institucionet financiare funksioni i pajtueshmërisë duhet të kërkohet të jetë në nivel të lartë

menaxherial. Tek paragrafi 2.6 i nenit 17 të ligjit për PPP/LFT ku kërkohet krijimi i organeve adekuate të kontrollit të rregullt të brendshëm për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe funksionin e auditimit për të testuar sistemin e raportimit dhe identifikimit, përveç për subjektet me numër të kufizuar të stafit, duhet të zgjerohet fushëveprimi i paragrafit duke përfshirë edhe subjektet me numër të kufizuar dhe funksioni i auditimit të mos kufizohet vetëm tek sistemi i raportimit dhe identifikimit, duke lënë anash përbërësit e tjerë të sistemit të PPP/LFT-së.

Dispozita sipas paragrafit 5 të nenit 24 të Ligjit të PPP-LFT-së duhet të specifikojnë se programet në nivel grupi duhet të jenë të përshtatshme (përveç që të jenë të zbatueshme) për të gjitha degët dhe filialet në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë dhe që ato të përfshijnë masat e përcaktuara në kriterin 18.1 (domethënë rregullat për menaxhimin e pajtueshmërisë, përzgjedhjen e punonjësve, trajnimin e punonjësve dhe funksionin e auditimit të pavarur), si dhe të kërkojnë në mënyrë specifike që këto programe në nivel grupi të përfshijnë mbrojtje të përshtatshme të konfidencialitetit dhe përdorimit të informacionit të shkëmbyer, përfshirë masat mbrojtëse për të parandaluar nxjerrjen e informacionit.

Po ashtu të specifikohen dispozita të cilat kërkojnë që:

- i) Kur kërkesat minimale për PPP/LFT-në të vendit pritës janë më pak të rrepta se ato në Kosovë, bankat dhe institucionet e tjera financiare të sigurojnë që degët e tyre të huaja dhe filialet, në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë, të zbatojnë masat e PPP/LFT-së në përputhje me kërkesat në Kosovë deri në masën që ligjet dhe rregulloret e vendit pritës e lejojnë këtë; dhe
- ii) Kur vendi pritës nuk lejon zbatimin e duhur të masave të PPP/LFT-së në përputhje me kërkesat në Kosovë, bankat dhe institucionet e tjera financiare të aplikojnë masa të përshtatshme shtesë për menaxhimin e rreziqeve të PPP/LFT-së dhe informojnë mbikëqyrësit në Kosovë (kriteri 18.3).

Rekomandimi 19 – Vendet me rrezikshmëri më të lartë

Në mbështetje të paragrafit 6 të nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT, të gjitha subjektet raportuese zbatojnë masat e kujdesit të duhur të shtuar që janë efektive dhe në përpjesëtim me rreziqet e identifikuar për marrëdhëniet dhe transaksionet e biznesit me persona fizikë dhe juridikë, përfshirë institucionet financiare nga shtetet që mund të përcaktohen nga NjIF-K, bazuar në masat ndërkombëtare ndaj shteteve të tilla. Subjekteve raportuese nuk u kërkohet shprehimisht me ligj të aplikojnë kujdes të shtuar ndaj klientit për marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet me persona nga shtetet për të cilët kërkohet nga FATF-ja (kriteri 19.1), kjo është rregulluar dhe përcaktuar me udhëzuesin FIUAD 70/2018 të lëshuar nga NjIF-K më 8 maj 2018 i cili rekomandon zbatimin e KDK-së së shtuar për personat fizikë dhe juridikë që ndërlidhen me juridiksionet e renditura nga FATF-ja. Megjithatë statusi juridik i udhëzuesit si një akt jo i detyrueshëm nuk parasheh pajtueshmërinë me kërkesat e kriterit andaj, kjo duhet harmonizuar me ligji në mënyrë që të jetë obligim i detyrueshëm. Po ashtu me qëllim të përmbushjes së kriterit (kriteri 19.2) legjislacioni duhet paraparë kërkesa për të zbatuar kundërmasa kur kërkohet nga FATF të cilat janë proporcionale me rreziqet dhe masat për të siguruar që institucionet financiare janë të këshilluara

për shqetësimet rreth dobësive në sistemet e PPP/LFT-së të vendeve të tjera që nuk janë të mjaftueshme (kriteri 19.3).

Rekomandimi 20 – Raportimi i transaksioneve të dyshimta

Tek ky rekomandim Kosova është kryesisht në përputhje, andaj nuk rekomandohet ndonjë ndryshim specifik, përveç mangësisë në kriminalizimin e pastrimit të parave ku përfshihet mungesa e kriminalizimit të manipulimit të tregut.

Rekomandimi 21 – Zbulimi dhe konfidencialiteti

Sipas Raportit të Vlerësimit për Pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 21, ajo që tutje duhet kushtuar vëmendje ka të bëjë me dispozitat që ndalojnë nxjerrjen e informacionit shpjegues për paraqitjen e RTD-ve ose informatave përkatëse që sipas interpretimit të ekspertëve lënë hapësirë për interpretimin se ato nuk zbatohen për të gjithë personelin e subjekteve raportuese por vetëm personelin që bënë përgatitjen ose transmetimin e raporteve të tilla sipas ligjit për PPP/LFT, si dhe të ketë rregullim specifik për të siguruar që këto dispozita nuk kanë për qëllim të pengojnë shkëmbimin e informacionit sipas Rekomandimit 18 (kriteri 21.2).

Rekomandimi 22 – Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jo-Financiare (BPPJF) - Kujdesi i duhur ndaj klientit

Lidhur me këtë rekomandim, ndër të tjera, përkundër faktit që në Kosovë me Ligjin Nr. 06/L -155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit, ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës një ndër të metat e identifikuar në ligjin për PPP/LFT ka të bëjë me mungesën e kërkesës që kazinotë të zbatojnë të gjitha masat e KDK-së (në krahasim me identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit) sa herë që klientët angazhohen në transaksione financiare të barabarta ose mbi pragun e përcaktuar, si dhe duhet siguruar që ata janë në gjendje të lidhin informacionin e KDK-së për një klient të caktuar me transaksionet që klienti kryen në kazino (kriteri 22.1 (a)), andaj kjo dispozitë ligjore duhet të plotësohet dhe të jetë relevante kurdo që mund të jetë e aplikueshme.

Tek subjektet raportuese, përveç avokatëve dhe noterëve kërkohet që sipas FATF edhe “profesionet e tjera ligjore të pavarura” të përcaktohen si subjekte raportuese sipas ligjit dhe “kryerja e funksionit të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike” të përcaktohet si shërbim i caktuar sipas ligjit (kriteri 22.1 (e)).

Rekomandimi 23 – Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jo-Financiare (BPPJF) - Masat e tjera

Lidhur me arritjen e pajtueshmërisë me këtë rekomandim kërkohet të përmbushen kërkesat për të raportuar transaksione të dyshimta në të gjitha situatat kur profesionistët në fjalë angazhohen në një transaksion “në emër të ose për klientin”. “Profesionet e tjera ligjore të pavarura” si dhe situata të caktuara tek disa BPPJF të cekura më lartë sikurse në rekomandimin 22 shembull “kryerja e funksionit të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike” pasi të përcaktohen si

subjekte apo të detyruara sipas ligjit të mbulohen me kërkesën për të paraqitur RTD (kriteri 23.1 (c)).

Në akte nënligjore të bëhet përcaktimi i kritereve “i përshtatshëm” dhe “i duhur” për zyrtarë të pajtueshmërisë së BPPJF-ve dhe krijohen procedura të përzgjedhjes për punësimin e personelit në funksione përkatëse për PPP/LFT-në, të kërkohej disponueshmëria e një funksioni të auditimit të pavarur për një fushë dhe numër të pidentifikuar të BPPJF-ve “me numër të kufizuar të stafit” dhe kërkesa për testimin e auditimit të mbulon jo vetëm sistemet e raportimit dhe identifikimit por edhe përbërësit e tjerë të sistemit për PPP/LFT-në (kriteri 23.2).

Rekomandimi 24 – Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë

Bazuar në rekomandimin 24 të FATF, vendet duhet të marrin masa për të parandaluar keqpërdorimin e personave juridikë për pastrim parash ose financim të terrorizmit. Vendet duhet të sigurojnë që ka informacion adekuat, të saktë dhe në kohë mbi pronësinë përfituese dhe kontrollin e personave juridikë që mund të merren ose të kenë qasje në kohën e duhur nga autoritetet kompetente. Gjithashtu, vendet duhet të marrin në konsideratë masat për të lehtësuar qasjen në informacionin e pronësisë përfituese dhe kontrollit nga institucionet financiare dhe BPPJF-të që ndërmarrin kërkesat e përcaktuara në Rekomandimet 10 dhe 22.

Autoritetet kompetente duhet të jenë në gjendje të marrin, ose të kenë qasje në kohën e duhur, në informacionin e duhur, të saktë dhe aktual mbi pronësinë dhe kontrollin përfitues të kompanive dhe personave të tjerë juridikë dhe zgjedhin mekanizmat në të cilët mbështeten për të arritur këtë objektiv dhe kur është e nevojshme të përdorin një kombinim mekanizmesh për të arritur objektivin.

Si pjesë e procesit të sigurimit të transparencës adekuate në lidhje me personat juridikë, vendet duhet të kenë mekanizma që:

- Identifikojnë dhe përshkruajnë llojet e ndryshme, format dhe tiparet themelore të personave juridikë në vend;
- Identifikojnë dhe përshkruajnë proceset për krijimin e atyre personave juridikë, si dhe marrjen dhe regjistrimin e informacionit themelor dhe përfitues të pronësisë;
- Të bëjë publik informacionin e mësipërm; dhe
- Vlerësojnë rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të lidhura me lloje të ndryshme të personave juridikë të krijuar në vend.

Gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë Kosovës me standardet ndërkombëtare nga ekspertët në kuadër të Projektit PECK është theksuar se Kosova nuk kishte ndërmarrë ndonjë vlerësim të rreziqeve të PP/FT-së që lidhen me llojet e ndryshme të personave juridikë dhe nuk kishte mekanizma ekzistues për të identifikuar dhe përshkruar procesin e identifikimit dhe regjistrimit të informacionit të pronësisë përfituese. Lidhur me vlerësimin e rreziqeve të PP/FT-së që lidhen me llojet e ndryshme të personave juridikë tanimë ka filluar ky lloj vlerësimi sektorial i cili tani gjendet në fazën e finalizimit dhe rezultatet e tij pritet të publikohen.

Sa i përket informatat themelore të pronësisë për personat juridikë ato bëhen publikisht të disponueshme nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, mirëpo këta persona juridik nuk janë të detyruara të mbajnë të gjitha informacionet e aksionarëve. Nuk ekzistojnë kërkesa për të siguruar disponueshmërinë e informacionit të pronësisë përfituese, përditësimin ose mirëmbajtjen e tij. Mekanizmat e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar për shkëmbimin e informacionit të pronësisë përfituese nuk ekzistojnë në mënyrë specifike, si dhe garancitë e aksioneve bartëse nuk rregullohen as ndalohen me legjislacionin në fuqi.

Me qëllim të adresimit të këtyre mangësive të identifikuar dhe arritjes së pajtueshmërisë me këtë rekomandim Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë fillimisht ka krijuar grupin punues për hartimin e koncept dokumentit me qëllim të trajtimit të kësaj fushe dhe adresimit të mangësive të identifikuar. Koncept Dokumenti për Regjistrin e Pronësisë Përfituese është miratuar nga Qeveria me Vendimin Nr. 22/86 të datë 04/07/2022. Pastaj, Ministria me Vendimin Ref 02/Nr. 320, datë 06/10/2022 ka krijuar Grupi Punues për hartimin e Projektligjit për Regjistrin e Pronësisë Përfituese i cili pritet të procedohet për miratim të mëtutjeshëm.

Ky Projektligj trajton krijimin e Regjistrit për Pronarët Përfitues i cili regjistër do të mundësonte rregullimin e një fushe tejet të rëndësishme në një instrument të vetëm ligjor. Kjo jo vetëm që do të lehtësonte punën e organeve zbatuese të ligjit, subjekteve të detyruara për raportim, mirëpo edhe do të rregullonte qasjes në informacion të përshtatshëm, të saktë dhe aktual mbi pronarët përfitues të bizneseve dhe subjekteve të tjera juridike.

Projektligji përcakton Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës si autoritet përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit të Pronarëve Përfitues.

Pastaj rregullon edhe çështjet tjera që ndërlidhen me:

- detaje për të dhënat e detyrueshme që duhet të regjistrohen dhe të mbahen të azhurnuara në Regjistër; vendosjen e masave të nevojshme për të garantuar sigurinë e të dhënave; obligimin për të regjistruar dhe azhurnuar informacionin e kërkuar të pronësisë në Regjistër; afatet kohore brenda të cilave informacioni i kërkuar i pronësisë duhet të regjistrohet dhe azhurnohet; dispozita për mënyrën dhe procedurën e konsultimit të të dhënave për pronarët përfituese në Regjistër; përcakton autoriteteve kompetente të cilave u jepet qasje e lirë, e drejtpërdrejtë dhe e pakufizuar në të gjitha të dhënat e pronësisë përfituese në Regjistër dhe subjektet raportuese dhe persona të tjerë që kanë interes legjitim për të pasur qasje në të gjitha të dhënat e pronësisë përfituese; siguron të drejtën e parashtrimit të kërkesës për pajisje me ekstrakt nga ky Regjistër; përcakton periudhën minimale për mbajtjen e të dhënave të pronësisë përfituese; siguron të drejtën për të paraqitur ankesa administrative tek palët përkatëse dhe përmban dispozita që detajojnë mekanizmin për parashtrimin e ankesave të tilla; si dhe vendos sanksione kundërvajtësve për shkelësit e ligjit.

Grupi punues do të konsiderojë po ashtu kërkesat e Direktivës së 4-të dhe të 5-të të BE-së për AML, që përshkruajnë krijimin e një regjistri qendror për informacione rreth pronësisë përfituese lidhur me personat juridikë që janë të inkorporuar në Kosovë.

Rekomandimi 25 – Transparenca dhe pronësia përfituese e marrëveshjeve juridike

Vlerësimi ka konkluduar se kriteret e këtij Rekomandimi janë plotësuar gjerësisht. Sistemi, megjithatë, do të përfitonte nga amendamentet e ligjit të cilat do të adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë masa për të parandaluar keqpërdorimin e marrëveshjeve ligjore. Veçanërisht, masat do duhej të merren për të futur një kërkesë ligjore për një administrator të besuar që të zbulojë statusin e tij/saj te Inteligjenca Financiare dhe BPPJF-të gjatë themelimit të marrëdhënieve të biznesit dhe sanksioneve respektive. Për më tepër, Direktiva e 4-të dhe e 5-të e BE-së për AML ka futur kërkesa për të vendosur një regjistër qendror për informacionet e pronësisë përfituese të administratorit të besuar, kur ato shkaktojnë pasoja tatimore në vend. Përderisa asnjë marrëveshje nuk mund të vendoset sipas ligjeve të Kosovës, nuk ka ndalesa për administratorët e huaj të besueshëm që të kenë llogari bankare (ose që të jenë llogaritë bankare të pronarëve përfitues) në Kosovë, ose për një banorë që të veprojnë si administrator i besuar për një marrëveshje të themeluar në një vend tjetër. Nëse në këto rrethana marrëveshjet gjenerojnë pasoja tatimore në Kosovë, ato aktivizojnë kërkesat e direktivës së BE-së për themelimin e një regjistri qendror për marrëveshje (dhe marrëveshje të tjera të ngjashme ligjore) lidhur me informacionet për pronësinë përfituese.

Me qëllim të adresimit të këtyre mangësive të identifikuara dhe arritjes së pajtueshmërisë me këtë rekomandim Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, siç është elaboruar më sipër tek *Rekomandimi 24 – Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë* ka hartuar Projektligjit për Regjistrin e Pronësisë Përfituese i cili pritet të procedohet për miratim të mëtutjeshëm. Për detajet e tjera sqaruese shih rekomandimin 24 të këtij Koncept Dokumenti.

Rekomandimi 26 – Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve

Rekomandimi 26 është vlerësuar si pjesërisht në përputhje. Përderisa një numër çështjesh të vërejtura në raport (p.sh. zbatim i tërësishëm dhe efektiv i parimeve bazë të Bazelit dhe mungesa e një qasjeje të plotë të bazuar në rrezik për mbikëqyrjen e institucioneve financiare) nuk kërkojnë ndryshime legjislative dhe mund të adresohen duke korrigjuar kornizën e brendshme të mbikëqyrësit dhe, në rastin e çështjes në fjalë në lidhje me përgjegjësinë e përbashkët ndërmjet bankës qendrore dhe NjIF-it, ata mund të rregullohen me një marrëveshje ndërmjet këtyre institucioneve, ka një sërë çështjesh që kërkojnë ndryshime në kornizën ligjore, p.sh.

- i) Për bankat dhe kompanitë e sigurimeve, mungon një gjuhë e qartë për të parandaluar hyrjen e bashkëpunëtorëve të kriminelëve në tregun financiar si mbajtës (ose pronarë përfitues) të një interesi të rëndësishëm ose kontrollues;
- ii) Për institucionet financiare jo-bankare, mungon:
 - a) gjuha e qartë për të parandaluar personat me përvojë kriminale të mbajnë (ose të jenë pronarë përfitues) të një interesi të rëndësishëm ose kontrollues, ose të mbajnë një funksion drejtues, në një IFJB ; dhe
 - b) kërkesa për të parandaluar bashkëpunëtorët e kriminelëve të bëjnë të njëjtën gjë; iii) për institucionet mikrofinanciare, nuk ka kërkesa për të parandaluar personat me përvojë

kriminale ose bashkëpunëtorët e tyre që të kenë (ose të jenë pronarë përfitues) një interes të rëndësishëm ose kontrollues, ose të mbajnë një funksion drejtues në një MOFI.

Ndryshim të ligjit për Bankat dhe Institucionet financiare jo bankare

Legjislacioni i referohet aftësisë së BQK-së për të ushtruar mbikëqyrje efektive të konsoliduar, me sa duket edhe për qëllime PPP/LFT, por pa dispozita të mëtejshme në ligj ose mjete të tjera të detyrueshme për të siguruar mekanizmat dhe mjetet për zbatimin praktik të tij.

Ndryshim i legjislacionit përkatës lidhur me AML/CFT

Rekomandimi 27 – Autorizimet e mbikëqyrësve

Kosova është vlerësuar si pjesërisht në përputhshmëri me këtë rekomandim, pjesërisht për shkak të çështjes së autoriteteve të përbashkëta mbikëqyrëse nën Rekomandimin 26 por edhe sepse

- i) Mekanizmi për zbatimin e fuqisë së mbikëqyrësit për të detyruar prodhimin e ose për të fituar qasje në çfarëdo informacioni përkatës lidhur me pajtueshmërinë e monitorimit me kërkesat e PPP/LFT duket se ka bazë në nevojën për të kërkuar një udhër nga gjykata sepse
- ii) mbikëqyrja nuk e ka fuqinë për të kufizuar ose suspenduar licencën e institucionit financiar për dështimin që të përputhet me kërkesat PPP/LFT.

Përderisa mungesa e parë kërkon një vlerësim rreth përputhjes së paragrafëve 3-5 të Nenit 35 të Ligjit për PPP/LFT me këtë kërkesë të FATF-së, i dyti kërkon një amendament të ligjit PPP/LFT për të krijuar kompetencën e BQK-së që të kufizojë/suspendojë një licencë.

Rekomandimi 28 – Rregullimi dhe mbikëqyrja e BPPJF-ve

Kosova është vlerësuar pjesërisht në përputhje në këtë rekomandim, mirëpo vetëm njëra nga çështjeve që janë vërejtur në vlerësim kërkon ndryshim legjislativ pasi që të tjerat mund të adresohen duke nënshkruar Memorandume të mirëkuptimit midis rregullatorëve/mbikëqyrësve sektorialë dhe NJIF-K dhe duke lëshuar procedura dhe manuale të brendshme për zbatimin e një qasje e plotë e bazuar në rrezik ndaj mbikëqyrjes. Kjo çështje ndërlihet me mungesën e masave të duhura në legjislacionin sektorial për t'i parandaluar kriminelet ose bashkëpunëtorët e tyre që të akreditohen profesionalisht ose të kenë (ose të jenë pronarë përfitues të) një interesi të rëndësishëm ose kontrollues ose të mbajnë një funksion menaxhimi në BPPJF-ve.

Rekomandimi 29 – Njësitë për Inteligjencë Financiare (NJIF)

Kosova është vlerësuar si kryesisht në përputhje me këtë rekomandim. Megjithatë, duhet vërejtur se direktiva e 5-të e BE-së e ka rritur në masë të madhe pushtetin e NJIF për t'u qasur dhe marrë informacione. NJIF-K ka që tani të drejta të mëdha lidhur me kërkesat për informacione nga subjektet raportuese, pavarësisht se a është paraqitur apo jo një RTD (që është tanimë e qartësuar në direktivën e 5-të të BE-së). Megjithatë, raporti i vlerësimit vëren se nuk ka afate strikte në ligj sa i përket pranimit të informacioneve shtesë nga subjektet raportuese dhe për pranimin e informacioneve nga autoritetet publike. Për më tepër, sipas Direktivës së 5-të, fushat e tjera ku NJIF do duhej të kishte qasje në të dhëna dhe informacione janë i) informacionet e PP të përfshira në regjistra e PP për subjektet juridike dhe marrëveshjet ligjore, në të cilat NJIF do duhej të kishte

qasje të pakufizuar; ii) mekanizma të centralizuar automatikë, si regjistrat qendrorë ose sistemet elektronike e rikuperimit të të dhënave, të cilat mundësojnë identifikimin, në një kohë të duhur, të çfarëdo personi fizik ose juridik që mbajnë ose kontrollojnë llogaritë e pagesës dhe llogarite bankare të identifikuara përmes IBAN dhe kasafortat të mbajtura nga një institucion kreditues, i cili do duhej të ishte drejtpërdrejtë i qasshëm në mënyrë të menjëhershme dhe të pa filtruar nga NJIF-et kombëtare; iii) NJIF-K duhet të ketë qasje në informacione që lejojnë identifikimin, në kohë të duhur, të çfarëdo personi juridik ose fizik në pronësi të patundshmërisë, përfshirë përmes regjistrave ose sistemeve elektronike të rikuperimit të të dhënave ku regjistra ose sisteme të tilla janë në dispozicion. Veçanërisht, këto çështje do duhet të vlerësohen në funksion të kërkesave të vendosura në Direktivën e 5-të të AML e cila thotë se: “*NjIF-të duhet të kenë qasje në informacion dhe të jenë në gjendje ta shkëmbejnë atë pa pengesa, duke përfshirë bashkëpunimin e duhur me autoritetet e zbatimit të ligjit. Në të gjitha rastet e dyshuar të kriminalitetit dhe, veçanërisht, në rastet që përfshijnë financimin e terrorizmit, informacioni duhet të rrjedhë drejtpërdrejt dhe shpejt pa vonesa të panevojshme.*”

Rekomandimi 30 – Përgjegjësitë e Autoriteteve të Zbatimit të Ligjit dhe atyre të Hetimit

Ky rekomandim u vlerësua kryesisht në përputhje; e vetmja çështje e rëndësishme e vërejtur në vlerësim është nevoja për të vendosur procedura specifike për e hetimeve paralele financiare, si dhe për gjurmimin e pasurisë, që nuk kërkon masa legislative.

Rekomandimi 31 – Kompetencat e Autoriteteve Zbatuese dhe atyre të Hetimit

Ky rekomandim u vlerësua kryesisht në përputhje; e vetmja çështje që vihet re është se nuk ka mekanizma në dispozicion për të identifikuar kontrollin e llogarive. Në dritën e kërkesës në Direktivën e 5-të për të siguruar qasje nga "autoritetet kompetente kombëtare" në regjistrin e llogarive bankare (tashmë ekzistuese në Kosovë) dhe në regjistrin e kasafortës (ende nuk është krijuar), do të duhet të merren masa t'u mundësohet një qasje e tillë autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit (Prokuroria, Policia e Kosovës, Administrata Tatimore, Dogana, Agjencia Kundër Korrupsionit), gjatë kryerjes së hetimeve financiare për PP, veprat kryesore të ndërlidhura dhe FT.

Rekomandimi 32 – Korrierët e parave të gatshme

Ky rekomandim u vlerësua kryesisht në përputhje. E vetmja çështje që mund të kërkojë ndryshim ligjor (qoftë me rishikim të paragrafit 2 të nenit 33 të Ligjit për PPP/LFT ose me udhëzime përmes akteve nënligjore) është adresimi i disa kufizimeve në lidhje me marrjen e informacionit nga posta, transportuesi i mallrave ose korrieri tregtar.

Rekomandimi 33 – Statistikat

Sipas vlerësuesve, statistikave të integruara nuk mbahen në atë mënyrë që të lejojnë vlerësimin e efektivitetit të sistemi LPP/LFT. Ky rekomandim është vlerësuar pjesërisht në pajtueshmëri për shkak të çështjeve lidhur me mbledhjen dhe mbajtjen e statistikave, të cilat mund të adresohen ose me akte nënligjore dhe/ose duke rritur zbatimin efektiv të mekanizmave ekzistues për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e statistikave.

Sa i përket këtij rekomandimi nga koha kur është dhënë ka disa zhvillime, pasi që Kosova ka implementuar Sistemin për Menaxhim Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe ndërlidhja e sistemeve të Policisë, sistemit të prokurorisë dhe atij të gjykatave me këtë sistem. Megjithatë, kërkohet të shqyrtohen se cilat statistika është rekomanduar të mbahen dhe të përditësohen janë të ndërmerren hapat e nevojshëm me qëllim të adresimit të rekomandimit.

Rekomandimi 34 – Udhëzime dhe komente

Ky rekomandim është vlerësuar në përputhje, nuk nevojiten masa.

Rekomandimi 35 – Sanksionet

Ky rekomandim u vlerësua pjesërisht në përputhje, pasi ka disa mangësi teknike në lidhje me përkufizimin dhe mospërputhje thelbësore në lidhje me klasifikimin e shkëlqeve të kërkesave të LPP/LFT dhe nuk duket se Ligji LPP/LFT ofron një sërë sanksionesh proporcionale dhe bindëse. të merren me persona fizikë ose juridikë që nuk përmbushin kërkesat e LPP/LFT. Mund të kërkohen ndryshime legislative për të adresuar këto çështje.

Rekomandimi 36 – Instrumentet Ndërkombëtare

Ky rekomandim është vlerësuar si i pazbatueshëm për Kosovën, prandaj nuk nevojiten masa.. Rekomandimi kërkon nga vendet që të bëhen palë në Konventën e Vjenës, Konventën e Palermos, Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (Konventa Merida) dhe Konventën për Financimin e Terrorizmit.. Kjo nuk varet nga Kosova, andaj konsiderohet si i pazbatueshëm.

Rekomandimi 37 – Ndihma e ndërsjellë juridike

Ky Rekomandim u vlerësua kryesisht në përputhje, megjithëse disa nga çështjet e vërejtura - një ndikim i kufizuar i kriminalitetit të dyfishtë në lidhje me bashkëpunimin me TF, shih Rekomandimin 5 për kriminalizimin e FT-së), dhe mungesa e afateve strikte në ligj - mund të kërkojnë ndërhyrje ligjore.

Rekomandimi 38 – Ndihma e ndërsjellë juridike: Ngrirja dhe konfiskimi

Ky rekomandim u vlerësua pjesërisht në përputhje pasi shumica e kërkesave të FATF në këtë rekomandim nuk ishin të pranishme në kornizën e brendshme të Kosovës. Kjo do të kërkojë një rishikim të legjislacionit për ngrirjen dhe konfiskimin, duke përfshirë: Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurive, Ligjin nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Ligji për NNJ.

Disa nga rekomandimet e lartcekura tek ndihma e ndërsjellët juridike si dhe ngrirja dhe konfiskimi tanimë janë adresuar, konkretisht nëpërmjet Ligjit Nr. 06/L-087 Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, ndryshimeve të Kodit Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, Ligji Nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, Ligji 08/L-121 për Byronë

Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, ndërsa Ligji Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është në plotësim ndryshim si dhe gjithashtu mbetet për tu adresuar çështja e Zyrës për Rekuperimin e Aseteve.

Rekomandimi 39 – Ekstradimi

Ky rekomandim u vlerësua pjesërisht në përputhje, për shkak të shqetësimeve të rëndësishme në lidhje me aftësinë e autoriteteve për të ekzekutuar kërkesat për ekstradim pa vonesa të panevojshme. Megjithatë, kjo mangësi nuk kërkon miratimin e masave ligjore

Rekomandimi 40 – Forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar

Ky rekomandim u vlerësua kryesisht në përputhje; janë vërejtur vetëm disa mangësi teknike në lidhje me kompetencat e paqarta të autoriteteve mbikëqyrëse për të shkëmbyer informacione, të cilat nuk kanë nevojë për ndryshime legjislative.

Grupi punues është i mendimit se me adresimin e këtyre çështjeve dhe problemeve të identifikuara, jo vetëm që do të arrihet një pajtueshmëri më e lartë standardet ndërkombëtare të FATF dhe Direktivën e BE-së, mirëpo edhe do të ndikon në intensifikimin e parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

Në vijim është paraqitur pema e problemit e cila shqyrton shkaqet dhe efektet që prodhon ky problem.

Figura 3: Pema e problemit që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Rrezikimi i stabilitetit ekonomik dhe ekonomisë së Kosovës
Problemi kryesor	Mos-pajtueshmëri teknike dhe nevoja e harmonizimit të mëtutjeshëm të legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtarë të FATF dhe aquis communautaire
Shkaqet:	Mangësitë ligjore për shkak të avancimit dhe ndryshimeve të standardeve të FATF dhe Direktivës së BE-së

Grupi punues ka gjetur se mangësitë ligjore tek korniza ligjore vendore i atribuohen avancimit dhe ndryshimeve të standardeve të FATF dhe Direktivës së BE-së të cilat përbëjnë shkakun kyç të problematikës së shtjelluar në kuadër të këtij Koncept Dokumenti. Legjislacioni ekzistues vendor nuk konsiderohet se siguron pajtueshmëri të mjaftueshme lidhur me avancimit dhe ndryshimet e fundit që ka pësuar kjo fushë. Pra, ndërkohë që një numër shtetesh po bëjnë avancim sa i përket ngritjes së pajtueshmërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, kur kthehemi kah legjislacioni vendor, shohim se Kosova nuk ka dispozita të qarta dhe të mjaftueshme sa i përket dispozitave të cilat kanë avancuar në kuadër të Direktivës së V të BE-së e që kanë të bëjnë me përmirësimin e transparencës ndaj pronarëve të vërtetë të kompanive dhe trusteve për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit përmes strukturave

të errëta; përmirësimin e punës së njëjësive të inteligjencës financiare me ndërlidhjen e regjistrave të pronësisë përfituese; trajtimin e rreziqeve të financimit të terrorizmit të lidhura me përdorimin anonim të valutave virtuale dhe të instrumenteve tjera të parapagimit “pre-paid”; përmirësimin e bashkëpunimit dhe forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve të mbikëqyrjes financiare sa i përket PPP/LFT; zgjerimi i kriterëve për vlerësimin e vendeve të treta me rrezik të lartë dhe sigurimi i një niveli të lartë të masave mbrojtëse për flukset financiare dhe përmirësimi i kontroleve për transaksione nga vendet e tilla.

Vlen të ritheksohet se Kosova ka ligj për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit i cili mbulon çështjet e PPP/LFT dhe i cili është në pajtueshmëri mjaft të madhe me standardet ndërkombëtarë të FATF, megjithatë siç u cek më lartë është i nevojshëm një rishikim i Ligjit për PPP/LFT për ta përditësuar atë në përputhje me Rekomandimet e rishikuara të FATF dhe Direktivën e Bashkimit Evropian 2018/843 e njohur si Direktiva e V-të e BE-së.

Megjithatë, në shumë iniciativa tjera legjislative, vërehet se janë trajtuar elemente të kësaj fushe, në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Punë të Jashtme është trajtuar çështje e sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me financimin e terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, ku tanimë është miratuar Ligji Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare Financiare të Shënjestruara .

Tutje në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Tregti dhe Industri kemi një iniciativë tjetër për rregullimin e Regjistrimit për Pronësinë Kosova duke pasur parasysh dokumentet e lartcekura dhe nevojën për rregullimin e fushë që ndërlidhet me identifikimin e pronësisë përfituese ka krijuar grupin punues për të hartuar Koncept Dokumentin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues i cili është miratuar nga Qeveria me Vendimin Nr. 22/86 të datë 04/07/2022. Po ashtu me Vendimin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Ref 02/Nr. 320, datë 06/10/2022 është krijuar Grupi Punues për hartimin e Projektligjit për Regjistrin e Pronësisë Përfituese dhe pritet që edhe kjo çështje të adresohet me miratimin e një ligji.

Tutje, vlen të theksohet se edhe Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës sa i përket çështjes së pronësisë përfituese ka nxjerr Udhëzimin Administrativ MF (NjIF-K) Nr. 01/2021 për Pronarin Përfitues për Subjektet Raportuese me qëllim të rritjes së transparencës së pronësisë përfituese, si dhe udhëzimit të subjekteve raportuese të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT, për identifikimin dhe verifikimin e pronarëve përfitues me qëllim të menaxhimit me efektivitet të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Një mënyrë apo në tjetrën Kosova vazhdon me ndërmarrjen e iniciativa sa i përket ngritjes së kornizës legjislative në fushën e PPP/LFT me qëllim të avancimit të saj me standardet ndërkombëtarë dhe evropiane në këtë fushë, si dhe sa i përket fuqizimit të luftimit të PP/FT dhe ngritjes së bashkëpunimit ndërkombëtarë. Andaj, edhe ky Koncept Dokument paraqet edhe një nga këto iniciativa ndër të tjera të lartcekura në këtë dokument.

Duke konsideruar gjithë kornizën ligjore dhe iniciativat legjislative në këtë fushë, ajo që rezulton është se ndonëse legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës normon në masë të madhe fushën e PPP/LFT, nevoja për avancim dhe rishikim të mëtutjeshëm të kësaj fushe është e pashmangshme.

Analiza e bërë për nevojat e këtij Koncept Dokumenti evidenton nevojën për të paraparë procedurat, specifikat, dhe kritere më të detajuara lidhur me disa nga kriteret e përcaktuara në kuadër të Rekomandimeve të FATF dhe Direktivës së V të BE-së.

Duke reflektuar në sundimin e ligjit, është e ditur se parandalimin, luftimi dhe sanksionimi i duhur i pastrimit të parave dhe luftimi i financimit të terrorizmit duhet bërë përmes ngritjes dhe forcimit të kornizës legislative por duke theksuar se veprimi kyç është edhe zbatimi në praktik i tij nga ana e subjekteve dhe autoriteteve kompetente të përcaktuara me ligj.

Andaj, mangësitë ligjore të prezantuara më lartë, pamundësojnë që Kosova të jenë në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtarë dhe Evropiane në këtë fushë, si dhe për subjektet dhe zbatuesit e ligjit në disa aspekte potencialisht mund të krijoj vështirësi në zbatimin praktik, kështu që përfundimisht duke vështirësuar edhe luftën ndaj pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

1.4. Palët e interesuara

Figura e mëposhtme liston palët e interesit të identifikuar në bazë të përkufizimit të problemit. Figura gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala	Efektet-et me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Njësia për Inteligjencën Financiare	Mangësitë ligjore	Vështirësi në parandalimin dhe luftimin e PP/FT	NJIF-K është institucioni qendror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave, përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.
Bordi i Njësia për Inteligjencën Financiare	Mangësitë ligjore	Vështirësi në koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave shtetërore për parandalimin dhe luftimin e PP/FT	Bordi Mbikëqyrës i Njesisë për Inteligjencë Financiare, mbikëqyrë dhe siguron pavarësinë e NJIF-K dhe kryen funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuar, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional në pajtim me qëllimet e ligjit për PPP/LFT.
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	Mangësitë ligjore	Vështirësi në hetimin e veprave penale të PP/FT	Prokuroria Speciale ka kompetencë të veçantë lëndore mbi “veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, e cila ndërlidhet me kapitullin XIV të Kodit Penal, i cili përfshin veprat penale të ndërlidhura me terrorizmin. Ndërsa sa i përket veprës penale të pastrimit të parave, Prokuroria Speciale ka juridiksion mbi veprën penale të pastrimit të parave të kryer së bashku me [të tjera] “vepra penale që janë në kompetencën e Prokurorisë Speciale, pavarësisht nga shumta apo përfitimi”. Prokuroria

			Speciale ka juridiksion edhe për veprën penale pastrimi i parave, të kryer “si një vepër e vetme penale, nëse vlera e shumës ose përfitimit është në shumën prej pesëqind mijë (500,000) Euro ose më shumë”.
Policia e Kosovës	Mangësitë ligjore	Vështirësi në hetimin e veprave penale të PP/FT	Policia e Kosovës pas vënies në dijeni apo pranimit të raporteve të inteligjencës nga autoritetet kompetente sipas autorizimeve bënë hetimet paraprake
Administrata Tatimore e Kosovës	Mangësitë ligjore	Vështirësi në hetimin e veprave penale të PP/FT	Administrata Tatimore e Kosovës sipas Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Nr. 04/L-223 është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, ligjit për tatimin në të Ardhurat Personale, Ligji për Tatimin në të Ardhurat nga Korporatat, Ligjit për Tatimin në Vlerën e Shtuar dhe çdo legjislacioni tjetër në Kosovë, e që i ngarkon detyrë të administroj çdo lloj tatimi. Sa i përket ndërlidhjes me fushën e PPP/LFT ajo ka obligime ligjore lidhur me luftimin e evazionit fiskal e cila është vepër e ndërlidhur penale me PP/FT.
Dogana e Kosovës	Mangësitë ligjore	Vështirësi në hetimin e veprave penale të PP/FT	Dogana e Kosovës përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit doganor i cili bën rregullimin e elementeve bazë të sistemit për mbrojtjen doganore të ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe të drejtat e obligimet e të gjithë pjesëmarrësve, në zbatimin e legjislacionit doganor. Sa i përket fushës së PPP/LFT ajo ka obligime ligjore të përcaktuara lidhur me zbatimin e neni 33 të Ligjit Nr. 05/L-096 - Deklarimi i detyruar i qarkullimit të instrumenteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës.
Banka Qendrore e Kosovës	Mangësitë ligjore	Vështirësi në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për PPP/LFT nga bankat dhe institucionet financiare	BQK-ja mbikëqyrë bankat dhe institucionet financiare në aspektin e pajtueshmërisë me detyrimet sipas Ligjit për PPP/LFT.
Ministria e Drejtësisë	Mangësitë ligjore	Harmonizimi i politikave legjislative që ndikojnë në parandalimin dhe	Ministria e Drejtësisë ndër të tjera bënë përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ushtron

		luftimin e PP/FT dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë	mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së profesioneve të lira, si dhe ofron ndihmë juridike ndërkombëtare në pajtim me ligjin në fuqi.
Departamentet përkatëse për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë përgjegjëse për Financa	Mangësitë ligjore	Ofrimi i përkrahjes në harmonizimin me aquis të BE-së	Zyra për Integrim Evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ndër të tjera është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes në përafrimin e Legjislacionit me aquis të BE-së.
Shoqata e Bankave të Kosovës	Mangësitë ligjore	Vështirësi në zbatimin e legjislacionit për PPP/LFT	Shoqata e Bankave të Kosovës është përfaqësuese e interesave të sektorit bankar të cilat janë subjekte raportuese të përcaktuara sipas paragrafit 1.1 të nenit 16 të ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe kanë obligime ligjore në kuadër të zbatimit të këtij ligji.
Organizatat e Shoqërisë Civile	Mangësitë ligjore	Vështirësi në zbatimin e legjislacionit për PPP/LFT	Organizatat Jo Qeveritare në Kosovë janë subjekte raportuese të përcaktuara sipas paragrafit 1.9 të nenit 16 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe kanë obligime ligjore në kuadër të zbatimit të këtij ligji.
Oda e Noterëve	Mangësitë ligjore	Vështirësi në zbatimin e legjislacionit për PPP/LFT	Noterët janë subjekte raportuese të përcaktuara sipas paragrafit 1.6 të nenit 16 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe kanë obligime ligjore në kuadër të zbatimit të këtij ligji.
Shoqata e Sigurimeve të Kosovës	Mangësitë ligjore	Vështirësi në zbatimin e legjislacionit për PPP/LFT	Shoqata e Sigurimeve të Kosovës ka përfaqësuar interesat e sektorit të Kompanive të Sigurimeve të cilat janë subjekte raportuese të përcaktuara sipas paragrafit 1.2 të nenit 16 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe kanë obligime ligjore në kuadër të zbatimit të këtij ligji.
Projekti Kundër Krimit Ekomomik PECK II	Mangësitë ligjore	Ofrimi i përkrahjes përmes ekspertëve ndërkombëtarë të fushës	Qëllimi i Projektit është të forcojë kapacitetet institucionale për të luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në përputhje me standardet evropiane përmes asistencës teknike dhe vlerësimeve të synuara për përmirësimin dhe përmirësimin e reformave

			të krimit ekonomik. Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF) është një ndër institucionet kryesore homologe për këtë Projekt.
--	--	--	---

Kapitulli 2: Objektivat

Së pari, objektivi strategjik i kësaj politike, është forcimi i sundimit të ligjit përmes luftimit të dukurive negative me theks të veçantë pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimi i terrorizmit, të cilat janë objektiva këto që rrjedhin nga dokumenti kryesor planifikues i Qeverisë.⁷ Në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025 sundimi i ligjit është parimi themelor mbi të cilin do të punojë Qeveria dhe për këtë qëllim, do ta luftojmë pa kompromis krimin e organizuar e korrupsionin, terrorizmin, krimet ekonomike, dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe angazhimi për respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare. Kjo politikë synon gjithashtu të kontribuojë në parandalimi dhe luftimin e krimit i cili po ashtu është një ndër objektivat ku për këtë qëllim planifikohet ngritja e kapacitetet njerëzore, analitike dhe hetuese të mekanizmave të rendit dhe sigurisë, kompletimi dhe ndryshimi i kornizës strategjike dhe ligjore, si dhe rritja e ndërveprimit me institucionet tjera. Për këtë qëllim, planifikohet racionalizimi i kornizës strategjike, me qëllim të krijimit të një strategjie të konsoliduar shtetërore kundër krimit, e cila i përgjigjet rreziqeve reale dhe përmirëson koordinimin ndërinstytucional.

Ndër objektivat e Planit Kombëtar për Zhvillim 2023-2025, tek Shtylla VI – Qeverisja e Mirë, tek sektori i financave publike, sektori 02, qëllimi zhvillimor 10 - Qeveri Efektive dhe Llogaridhënëse, është paraparë edhe hartimi dhe aprovimi i Koncept Dokumentit për Luftimin e Parandalimit të Pastrimit të Parasë / Luftimi i Financimit të Terrorizmit.

Si objektive specifike e këtij koncept dokumenti në kuadër të këtyre objektiveve strategjike, është avancimi i kornizës ligjore për të arritur pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të FATF dhe ato Evropiane për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave, veprave të ndërlidhura penale dhe luftimin e financimit të terrorizmit, ndër to specifikisht përmirësimi i sistemit të PPP/LFT lidhur me politikat dhe koordinimin vendor, financimin e terrorizmit dhe përhapjes, si dhe masat parandaluese, mbikëqyrja dhe pronësia përfituese janë objektivat kyçe me qëllim të përmirësimit të Sistemit të PPP/LFT, i paraparë në Planin e Veprimit i Rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të PPP/LFT-së 2019 – 2023. Luftimi i evazioni fiskal i cili është ndër prioritetet e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare në të cilin po ashtu është planifikuar aprovimi i Koncept dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, në përputhje me praktikatat e BE-së, rekomandimet e PECK II, Raportit të Vendit 2018, është paraparë si masë për rritjen e shtrëngesës ligjore.

Kjo do të arrihet përmes masave të shqyrtuara në Kapitullin 3 të këtij Koncept Dokumenti.

⁷ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
<p><i>Objektivi strategjik</i> – Sundimi i ligjit përmes luftimit të krimit të organizuar e korrupsionit, terrorizmin, krimet ekonomike, dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe angazhimi për respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare.</p> <p>Tek Shtylla VI – Qeverisja e Mirë, tek sektori i financave publike, sektori 02, qëllimi zhvillimor 10 - Qeveri Efektive dhe Llogaridhënëse, ka veprimin - Hartimi dhe aprovimi i Koncept Dokumentit për Luftimin e Parandalimit të Pastrimit të Parasë / Luftimi i Financimit të Terrorizmit në Planin Kombëtar për Zhvillim-PKZH 2023-2025 për zbatimin e masës strategjike.</p>	<p>Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025</p> <p>Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2023-2025</p>
<p><i>Objektivat specifik</i> –</p> <p>Përmirësimi i sistemit të PPP/LFT lidhur me politikat dhe koordinimin vendor, financimin e terrorizmit dhe përhapjes, si dhe masat parandaluese, mbikëqyrja dhe pronësia përfituese janë objektivat kyçe me qëllim të përmirësimit të Sistemit të PPP/LFT.</p> <p>Evazioni fiskal paraqet kërcënim jashtëzakonisht të lartë për pastrimin e parave, andaj luftimi i tij është ndër prioritetet e Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit</p> <p>Objektivi Specifik I.2: Rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit. Masa për rritjen e shtrëngesës ligjore: Aprovimi i Koncept dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të</p>	<p>Plani i Veprimit i Rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të PPP/LFT-së 2019 – 2023 i aprovuar me vendim të Qeverisë Nr.05/52 me datë 24/12/2020.</p> <p>Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/25 me datë 24.12.2020</p> <p>Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2013.</p>

<p>Terrorizmit, në përputhje me praktikat e BE-së, rekomandimet e PECK II, Raportit të Vendit 2018.</p> <p>Masa e reformës #7: Reduktimi i ekonomisë joformale përmes përmirësimit të mbikëqyrjes së bazuar në inteligjencë: Rishikimi i metodologjisë së vlerësimit të rrezikut të NjIF-it sipas rekomandimeve të vlerësimeve dhe asistencës teknike në këtë fushë (NjIF);</p>	<p>Programi për Reforma në Ekonomi 2023-2025</p>
---	--

Kapitulli 3: Opsionet

Ky Koncept Dokument trajton të gjitha opsionet me të cilat mund të procedohet në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Siç është potencuar edhe më lartë, kjo është bërë me qëllim që produkti i cili del nga ky Koncept Dokument, të jetë sa më i përafërt me standardet bashkëkohore ndërkombëtare të kësaj fushe dhe rrjedhimisht të përmirësojë pajtueshmërinë e Kosovës sa i përket zbatimit të këtyre standardeve në vend.

Së këndejmi, Koncept Dokumenti trajton tre opsione kryesore lidhur me rishikimin e kornizës ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Opsioni *pa asnjë ndryshim* i cili parasheh ruajtjen e *status quo*; opsioni për *përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit të kornizës ligjore* i cili nuk parasheh ndryshime legjislative mirëpo fokusohet në zbatimin e ligjeve të cilat veçse ekzistojnë; dhe së fundi opsioni me *ndryshime legjislative* i cili parasheh ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit përmes ndryshimit të legjislacionit në fuqi. Ky Koncept Dokument adreson edhe ndikimet në ngarkesat administrative të cilat në këtë fushë duhet theksuar se tanimë vlerësohen nga institucionet relevante si minimale, pasi legjislacioni në fuqi që mbulon fushë e PPP/LFT nuk përmban procedura administrative me pagesë dhe raportimi bëhet online përmes sistemit elektronik. Megjithatë, ky legjislacion përmban dispozita të cilat parashohin marrjen dhe mirëmbajtjen e informacionit të obligueshëm, që mund të shkaktojnë ngarkesë administrative sa i përket ruajtjes dhe mbajtjes në dispozicion të informacionit në formë fizike,

Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni asnjë ndryshim nënkupton që nuk do të merren kurrfarë masa as zbatuese dhe as legjislative për të adresuar problemin kryesor, të shpjeguar më lartë. Me opsionin pa asnjë ndryshim do të vazhdonte të ekzistoj problemi kryesor lidhur me mangësitë e legjislacionit adekuat për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Rrjedhimisht, efektet të cilat mund t'i prodhojnë mangësitë e elaboruara në këtë koncept dokument, do të

vazhdojnë të mbesin rrezik potencial dhe do të ndikojnë negativisht që Kosova të mos jetë në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare të FATF dhe BE në këtë fushë

Rrjedhimisht, prezenca e këtyre mangësive në kornizën ligjore rrezikon stabilitetin financiar, parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale, financimin e terrorizmit, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtarë të Kosovës në këtë fushë.

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Një opion tjetër i shqyrtuar nga grupi punues është opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit. Pavarësisht diskutimeve dhe analizave të grupit punues, duke marr parasysh parimin e ligjshmërisë, ky opion është konstatuar se nuk është i përshtatshëm për të përmbushur obligimet ndërkombëtare të Kosovës në parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Dispozita të caktuara të cilat duhet rishikuar dhe avancuar kanë të bëjnë me obligimet ligjore të sanksionuara të institucioneve raportuese të cilat, sipas parimit të ligjshmërisë, nuk mund të rregullohen me legjislacionin sekondar.

Natyrisht, mënyra se si mund të përmirësohet zbatimi dhe ekzekutimi i legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit tani më të përcaktuara në legjislacionin e Kosovës, siç është shpjeguar më lartë, mund të përforcohet tutje, por kjo është jashtë fushëveprimit të këtij Koncept Dokumenti dhe në këtë mënyrë nuk do të adresojë problemi i identifikuar në Kapitullin 1 dhe nuk do të arriheshin objektivat e përcaktuara në Kapitullin 2, të këtij Koncept Dokumenti.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë [me ndryshime legjislative]

Opsioni i tretë do të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të kornizës ligjore të Kosovës në fushën e PPP/LFT me qëllim të prezantimit të dispozitave të reja në përputhje me standardet e FATF dhe BE-së. Hulumtimi i realizuar për qëllime të këtij Koncept Dokumenti ka identifikuar ka identifikuar dy modele të cilat mund të aplikohen për të adresuar mos-pajtueshmëritë e identifikuar krahas standardeve të FATF dhe Direktivave të BE-së. Modeli i parë parasheh plotësimin ndryshimin e ligjit për PPP/LFT me dispozita të caktuara, ndërsa modeli i dytë parasheh miratimin e ligjit të ri për PPP/LFT. Substanca e të dy modeleve të prezantuara është pothuajse e njëjtë dhe këto dallojnë vetëm në instrumentin ligjor që do të zgjidhët.

Figura 6. Analizë krahasuese e shteteve të cilat kanë ndryshuar legjislacionin në fushën e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit

3.3.1. Nën opsioni për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit

Nën opsioni 3.3.1 shtjellon mundësinë e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

Plotësim ndryshimi i ligjit ekzistues për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, konsiderohet të jetë zgjedhja më e mirë. Përpilimi i një ligji të ri nuk do të jetë i domosdoshëm, pasi që shumica e dispozitave të ligjit aktual janë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe evropiane dhe janë të mjaftueshme në fushëveprim. Ajo se çfarë duhet bërë konkretisht është plotësim ndryshimi i ligjit me qëllim të adresimit të mos-pajtueshmërive teknike të identifikuara sa i përket pajtueshmërisë me standardet e FATF dhe me Direktivën e IV të cilat janë paraqitur në këtë koncept dokument, raportin e vlerësimit të pajtueshmërisë për PPP/LFT dhe dokumentet strategjike shtetërore, si dhe hartimi i dispozitave të reja aty ku janë identifikuar mangësitë me qëllim të harmonizimit kryesisht me Direktivën e V-të të BE-së sa i përket dispozitave të cilat janë shtuar si kërkesa të reja në nivelin e BE-së pas vitit 2018 siç janë rregullimi i kornizës mbikëqyrëse në fushën e PPP/LFT të ofruesve të shërbimeve të aseteve virtuale, transparanca e pronësisë përfituese, përmirësimi i bashkëpunimit dhe forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve të mbikëqyrjes dhe të tjera. Në të ardhmen, siç është elaboruar sipër në këtë koncept dokument, tanimë është paralajmëruar se do ketë edhe ndryshime të tjera në fushën e PPP/LFT në nivel të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i plotësim ndryshimit të Ligjit për PPP/LFT është që të ndryshon nenet ekzistuese të Ligjit në fuqi të cilat janë relevante për ndryshime siç është diskutuar sipër në koncept dokument dhe ato të plotësohen/ndryshohen, ndërkohë duke integruar dispozitat e reja që janë shtuar si kërkesa ndërkombëtare nga FATF dhe Direktivat relevante evropiane të fushës.

Megjithatë, ndonëse plotësim ndryshimi i Ligjit për PPP/LFT është opsioni i preferuar dhe konsiderohet si zgjidhje më e mirë, ekzistojnë edhe rezerva sa i përket benefiteve që zgjedhja e këtij modeli mund të sjellë. Në këtë drejtim, duhet konsideruar se ekzistimi i më shumë akteve ligjore për të njëjtën çështje që rezulton nga ndryshimi dhe plotësimi i ligjit bazik, pa ekzistuar praktika e paraqitjes zyrtare të versionit të konsoliduar të ligjeve në vendin tonë do mund të shkaktonte konfuzion.

Arritja e rezultateve të kërkuara përkitazi me përmirësimin e sistemit të PPP/LFT lidhur me politikat dhe koordinimin vendor, financimin e terrorizmit dhe përhapjes, si dhe masat parandaluese, mbikëqyrja dhe pronësia përfituese të cilat janë objektivat kyçe me qëllim të përmirësimit të sistemit të PPP/LFT në zbatimin, siç theksohet në Planin e Veprimit të rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimin e

Financimit të Terrorizmit të miratuar me datë 24/12/2020 me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/52, mund të arrihet plotësisht duke e plotësuar dhe ndryshuar Ligjin ekzistues. Nuk kërkohet përpilimi i një ligji të ri për të arritur këto objektiva.

3.3.2. Nën opsioni për miratimin e ligjit të ri për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit

Nën opsioni 3.3.2 shqyrton mundësinë e miratimit të ligji të ri fushëveprimi i të cilit konsiston në Ligjin aktual për PPP/LFT. Përpilimi i një ligji të ri nuk do të jetë i domosdoshëm, pasi që shumica e dispozitave të Ligjit aktual janë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe janë të mjaftueshme në fushëveprim. Gjithashtu përpilimi i një Ligji krejtësisht të ri do të kërkonte në masë të konsiderueshme më shumë kohë dhe resurse, të cilat do të ishin të panevojshme duke pasur parasysh nevojat e identifikuar për ndryshime.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Në kuadër të këtij kapitulli paraqiten ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar lidhur me opsionet e analizuara në këtë Koncept Dokument.

Ndërkaq, shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Në tabelën e mëposhtme listohen ndikimet më të rëndësishme të identifikuar të dy opsioneve të para.

Figura 7: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuar për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuar	
	Opsioni 1	Opsioni 2
Ndikimet ekonomike	Ndikim negativ në zhvillimin ekonomik, luftimin e ekonomisë informale, pastrimin e parave, veprave të ndërlidhura penale dhe luftimin e financimit të terrorizmit	Ndikim negativ në zhvillimin ekonomik, luftimin e ekonomisë informale, pastrimin e parave, veprave të ndërlidhura penale dhe luftimin e financimit të terrorizmit

Ndikimet shoqërore	Ndikim negativ, pasi mund të ndikoj në inkurajimin e kriminalitetit në këtë fushë.	Ndikim negativ, pasi mund të ndikoj në inkurajimin e kriminalitetit në këtë fushë.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime.	Nuk ka ndikime.
Ndikimet në të drejtat themelore	Nuk ka ndikime.	Nuk ka ndikime.
Ndikimi gjinor	Infrastruktura ligjore aktuale nuk ka ndonjë ndikim gjinor të drejtpërdrejtë, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga gjinia.	Nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë gjinor, duke pasur parasysh se ligji i zbatueshëm adreson çështje jo specifike për nga gjinia.
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikime, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga barazia sociale	Nuk ka ndikime, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga barazia sociale.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga mosha.	Nuk ka ndikime, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga mosha.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Ndikim negativ pasi nuk ndikon në zvogëlimin e barrës administrative.	Ndikim negativ pasi nuk ndikon në zvogëlimin e barrës administrative.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka ndikime.	Nuk ka ndikime.

Ndikimet më të rëndësishme në kuadër të opsionit të tretë do të trajtohen veçmas në kuadër të tabelës vijuese. Ky elaborim do vlejë njëkohësisht për të dy modelet në kuadër të opsionit për ndryshime ligjore.

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuar – opsioni 3
Ndikimet ekonomike	Parandalimi i pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe luftimit të financimit të terrorizmit, zvogëlimin e ekonomisë joformale dhe stabilitet ekonomik.
Ndikimet shoqërore	Pritet të këtë ndikime sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, demotivimit të kriminalitetit në këtë fushë përmes ndëshkimit të personave që kryejnë vepra të tilla penale.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga mjedisi.

Ndikimet në të drejtat themelore	Nuk ka ndikime.
Ndikimi gjinor	Nuk ka ndikime, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga gjinia.
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikime, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga barazia sociale
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime, meqenëse adreson çështje jo specifike për nga mosha.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Zbatimi i këtij opsioni mund të ndikonte në zvogëlimin e barrës administrative.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka ndikime.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Nuk ka pasur sfida gjatë mbledhjes së të dhënave për qëllime të këtij Koncept Dokumenti

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Gjatë gjithë procesit të hartimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të merr parasysh propozimet e akterëve të ndryshëm relevant, konsultimet me ekspertët në fushën e caktuar, si dhe konsultimi me shoqërinë civile. Format e komunikimit do të jenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, grupet punuese dhe publikimet në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucioneve tjera përkatëse siç është Njësia për Inteligjencë Financiare, ku komunikimi do të jetë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe konstruktiv.

Më poshtë, në formë tabelare, janë paraqitur hapa që janë ndërmarrë dhe do ndërmerren në vazhdim nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në lidhje me komunikimin dhe konsultimin e Koncept Dokumentit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Figura 6: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Do të plotësohet edhe tutje pas konsultimeve të tjera

Procesi i konsultimit synon:

<p>Marrjen e të gjitha mendimeve nga palët që kanë qenë dhe janë të përfshira në zbatimin e ligjit aktual, që nga problemet, efektet e shkaktuara në praktikë, deri tek ndryshimet që duhet paraparë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.</p> <p>-</p>					
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi / njoftimi	Afati kohor	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara	Të gjitha palët e interesuara	Takim publik	Ftesa përmes postës elektronike; dhe Njoftimit përmes web faqes elektronike https://fiu.rks-gov.net/	13/08/2020	Flutra Blakçori Xërxa
Takimi i hapur për sektorin e OJQ-ve	Të gjitha OJQ-të e interesuara	Takim publik	Ftesa përmes postës elektronike në bashkërendim me Platformën CIVIKOS Njoftimit përmes web faqes elektronike https://fiu.rks-gov.net/	19/08/2020	Flutra Blakçori Xërxa
Prezantimi i Dokumentit Teknik	Institucionet me theks të veçantë PSRK	Prezantimi i Dokumentit Teknik “Rishqyrtimi i kompetencës ekskluzive të Prokurorisë Speciale mbi ndjekjen penale të pastrimit të parave”	Ftesa përmes postës elektronike për të gjithë anëtarët e Grupit Punues në koordinim me Projektin PECK III	11/05/2021	Flutra Blakçori Xërxa
Konsultim paraprak me shkrim	Të gjitha ministrinë dhe agjencitë	Njoftim lidhur me Koncept Dokumentin	Dërgimi me e-mail tek aktërët relevant	Nga data 08/09/2023 deri më 28/09/2023	
Konsultim i publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik	Dërgimi me e-mail tek aktërët relevant dhe publikimi në platformën elektronike	Nga data 16/11/2023 deri më 07/12/2023	

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Për adresimin e problemit të parashtruar në këtë analizë, tre opsione janë marrë në konsideratë: opsioni pa ndryshime, sipas të cilit situata aktuale dhe rrjedhimisht vështirësitë e paraqitura në praktikë do të vazhdonin; opsioni 2, i përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legislative; dhe opsionin 3 që ndërthet në vete dy modelet e tij, të cilat përmbajnë ndryshime legislative, gjegjësisht plotësim ndryshimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit dhe miratimin e ligji të ri për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit.

Opsioni 1 - Opsioni që të mos ndryshohet gjendja aktuale do rezultonte me vazhdimësi të problematikave të identifikuar në këtë Koncept Dokument. Në stadin e tanishëm sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, problematikat qëndrojnë si tek mangësitë në kornizën ekzistuese ligjore ashtu edhe tek moszbatimi i duhur dhe efektiv i dispozitave që rregullojnë këtë fushë. Kështu, me vazhdimin e status quo, do vazhdojë të ketë ngecje në numrin e rasteve dhe personave të dënuar për pastrim parash/ eventualisht financim terrorizmi i cili me shumë gjasë do të vazhdojë të mbetet i vogël dhe krahas kësaj do të shfaqet rreziku që kryesit e veprave penale të motivohen edhe më shumë për gjenerimin e të mirave materiale përmes aktiviteteve të tyre joligjore. Rrjedhimisht, do thellohet perceptimi mbi punën jo të drejtë dhe jo profesionale të institucioneve sa i përket demotivimit të suksesshëm të kriminalitetit. Gjithashtu problemi i mos-avancimit të kornizës ligjore apo mos-pajtueshmërisë me standardet e rishikuara të FATF dhe Direktivat e Be-së pamundësojnë që Kosova të bëhet anëtare e mekanizmave dhe organizatave ndërkombëtare në këtë fushë

Opsioni 2 – Opsioni i përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legislative potencialisht mund të ketë si rezultat zbatim më efikas dhe qartësim sa i përket legjislacionit aktual dhe rrjedhimisht edhe ngritje të lakores së procedimit të rasteve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo do tentohej të arrihej përmes intensifikimit të bashkëpunimit në mes të institucioneve zbatuese të ligjit të cilat kanë rol në procesin e parandalimit, hetimit dhe luftimit të PP/FT. Shtuar kësaj, përmirësimi i zbatimit të kornizës aktuale ligjore do synohej përmes avancimit të kapaciteteve profesionale të akterëve kyç sa i përket PP/FT me anë të organizimit të trajnimeve të posaçme si për autoritetet e zbatimit të ligjit, subjektet raportuese, prokurorët ashtu edhe për gjyqtarët të cilët merren me rastet e PP/FT. Megjithatë, kur flasim për avancimit të kapaciteteve vlen të theksohet se deri tani janë mbajtur mjaft seminare, takime e vizita madje edhe janë hartuar dokumente teknike dhe akte nënligjore për të lehtësuar punën, por përkundër të gjitha këtyre përpjekjeve vazhdon të ketë edhe vështirësi në zbatim, sepse mungesa në kornizën ligjore pamundësojnë zbatimin e përvojave të fituara. Nga kjo rezulton se ky opsion nuk flet shumë për një përmirësim të mirëfilltë të gjendjes aktuale.

Për më tepër, edhe sikur të arrihej specializimi dhe koordinim më i intensifikuar i organeve përgjegjëse për ndjekjen e këtyre veprave penale, prapë, legjislacioni në fuqi ndonëse i avancuar,

ka fushëveprim të kufizuar sa i përket dispozitave të reja të fuqizuara nga Direktiva e V e BE-së. Shtuar kësaj disa problem teknike të identifikuar në raportin e vlerësimit për PPP/LFT për Kosovën sa i përket pajtueshmërisë me standardet e FATF dhe Direktivës së IV të BE-së me zgjedhjen e këtij opsioni prapë do vazhdonin të ishin prezent problemet e identifikuara. Andaj, mund të thuhet se opsioni i përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative është i pamjaftueshëm për të bërë eliminimin e problemeve të identifikuara në këtë Koncept Dokument.

Opsioni 3 - Opsioni për ndryshime legjislative në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit e financimit të terrorizmit, ka për synim rritjen e përpjekjeve për të dekurajuar në maksimum pastrimin e parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit. Me avancimin e kornizës ligjore përmes ndryshimeve legjislative kemi mundësi që t'u japim autoriteteve të zbatimit të ligjit, organeve ndjekëse dhe atyre gjyqësore, fuqi ligjore me të cilin do ta luftonin më fuqishëm këto krime. Ky opsion jo vetëm do rregullonte kornizën aktuale ligjore duke por edhe do të përmirësonte dhe avanconte pozitën e Kosovës në sferën ndërkombëtare duke pasur parasysh faktin se Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës është shtet anëtarë në Egmont Grup me të gjitha të drejtat e plota sikurse shtetet e tjera anëtare dhe do të mundësonte intensifikimin e vazhdueshëm në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe aty ku është e mundshme përpjekjet për anëtarësime të reja në mekanizmat ndërkombëtarë në këtë fushë përfshirë MONEYVAL⁸.

Modeli i parë i opsionit 3 (3.1) i cili fton në ndryshimin e kornizës ligjore përmes plotësim ndryshimit të ligjit ekzistues për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit e Financimit të Terrorizmit, konsiderohet i përshtatshëm dhe i pranueshëm për arritjen e qëllimit të zgjidhjes përfundimtare dhe të qëndrueshme të problemit kryesor.

Ky model përmes plotësim ndryshimit të ligjit aktual është mjaft i shprehur edhe në regjion dhe më gjerë për shkak të ndryshimeve të evoluimit të shpejtë të metodave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përmes përdorimit të gjerë të shërbimeve dhe produkteve elektronike dhe ndryshimit të tipologjive, prandaj kjo mënyrë konsiderohet se është më praktike për avancimin e kornizës ligjore me qëllim të përcjelljes së trendëve të reja. Kjo po ashtu do të mundësonte që sa më parë të bëhej ngritje e nivelit të pajtueshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare të FATF dhe Direktivat relevante të BE-së në këtë fushë.

Në **Republikën e Shqipërisë** ligji bazik për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit është Ligji Nr.9917, datë 19.5.2008 i plotësuar dhe ndryshuar deri më tani gjashtë herë, dhe ndryshimi i fundit ka ndodhur me plotësim ndryshimin e datë 21.7.2023.

Republika e Maqedonisë ka përditësuar Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit e Financimit të Terrorizmit në vitin 2022, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë Nr. 151/2022 datë 04.07.2022.

⁸ https://www.coe.int/en/web/moneyval/moneyval-brief/statutory_documents

Republika e Malit të Zi, gjithashtu disa here ka ndryshuar Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit në vitin 2014, 2018,2019 dhe së fundmi në vitin 2021.

Modeli i dytë i opsionit 3 (3.2) miratimi i ligjit të ri do të sillte të njëjtin efekt por mund të jetë më shumë i ekspozuar ndaj vonesave dhe problematikave që mund të vijnë me procedurat e adoptimit tij e të cilat do të ishin të panevojshme. Njëkohësisht lë më shumë hapësirë për ndërhyrje në dispozitat ligjore të cilat tanimë janë vlerësuar se janë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane nga raporti i vlerësimit të vitit 2018 të pajtueshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit vlerësim i bërë me metodologjinë e MONEYVAL përmes Projekti PECK II në Kosovë.

Si përfundim, duke konsideruar dobitë dhe të metat që bartë në vete secili opsion i shtjelluar, opsioni 3 për ndryshimet legislative sipas modelit (3.1) përmes plotësim ndryshimit të ligjit aktual për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, vlerësohet më i përshtatshëm për të adresuar problematikat e identifikuara në këtë Koncept Dokument, dhe si i tillë do mundësonte në mënyrë më efektive parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe luftimin e financimit të terrorizmit, si dhe avancim e pozitës së Kosovës sa i përket pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane sa i përket kësaj fushe

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

[Përmbliidhni shkurtimisht Opsionin 2. Përshkruani se si ky opsion adreson problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e identifikuara në Pemën e Problemit.]

Figura 7: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i politikës								Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik								
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Objektivi Specifik 1	Produkti 1.1		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës
		Aktiviteti 1.1.1						

		Aktiviteti 1.1.2							
		Aktiviteti 1.1.3							
	Produkti 1.2								
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
	Aktiviteti 1.2.1								
Objektivi Specifik 2	Produkti 2.1	Etj.							
	Produkti 2.2	Etj.							
Objektivi Specifik N	Produkti N.1	Etj.							

[Përmblihdhni shkurtimisht Opsionin 3. Përshkruani se si ky opsion trajton problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e identifikuara në Pemën e Problemit.]

Figura 8: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Përafrimi i legjislacionit në fushën e PPP/LFT me standardet e përditësuar të FATF dhe Direktivat e BE-së në këtë fushë							Shifra e pritshme e kostos	
Objektivi strategjik	Sundimi i ligjit përmes luftimit të krimit të organizuar e korrupsionit, terrorizmin dhe krimet ekonomike me fokus parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.								
	Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Objektivi specifik 1	Produkti 1.1								
Përmirësimi i legjislacionit për parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit	Miratimi i rishikimeve ligjore për PPP/LFT		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.1.1 Formimi i Grupit Punues	Takime me akterët relevant	Plotësim ndryshimi dhe	Dërgimi i aproimit në Qeveri	Përcjellja për miratim në	Plotësim ndryshimi dhe	MFPT	

it të Terrorizmit, sipas standardeve të rishikuar të FATF dhe Direktiveve relevante të BE-së				hartim i dispozitivave ligjore për ligjin për PPP/LFT		Kuvend	hartimi i akteve nënligjore relevante		
	Aktiviteti 1.1.2 Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese për dispozitat e reja	Ofrimi i udhëzuesve për PPP/LFT	Trajnime për subjektet raportuese	Mbikëqyrja e pajtueshmërisë nga subjektet raportuese për dispozitat e reja ligjore	Ngritja e të kuptuarit të rreziqeve të PP/LFT-së tek subjektet raportuese	Ngritja e zbatimit të kontrolleve të brendshme dhe procedurave për identifikimin e rreziqeve të PP/LFT-së tek subjektet raportuese	NjIF-K		
	Aktiviteti 1.1.3	Ngritja e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për hetime	Rritja e mbikëqyrjes sipas qasjes së bazuar në rrezik nga	Rritja e mbikëqyrjes sipas qasjes së bazuar në rrezik	Rritja e konfiskimeve të pasurive të paligjshme produkti	Trajnime të specializuara për hetimin e rasteve të ndërlidhur	Prokuroria Special e, Policia, Dogana, ATK, NjIF-K, BQK		

			për PP/FT	NjIF- K	nga BQK	PP/FT dhe veprav e të ndërli dhura penale	me asetet virtua le		
Objektivi specifik 2	Produkti 2.1	Politikat dhe koordini min vendor	Zhvilli mi i VKR dhe mirati mi i metod ologjis ë	Trajni mi i akëtëv e kryeso r	Mbikë qyrja e zbatim it te qasjes se bazuar ne rrezik	Shqyr imi i hollësi shëm i kërcën imeve në VKR parapr ake	Zhvilli mi i doraca këve për të të kuptua rit e rreziq eve të PP/FT -së	MFPT dhe NjIF-K	
Përmirësi mi i sistemit të PPP/LFT lidhur me politikat dhe koordini min vendor, financimi n e terrorizm it dhe përhapjes , si dhe masat parandalu ese, mbikëqyr ja dhe pronësia përfituese	Produkti 2.2	Aktiviteti 1.1.2	Zhvilli mi dhe përdit ësimi i listës së indika torëve për FT dhe përhap jes	Ofrimi i udhëzi me të detaju ara për subjek tet raport uese për përhap jen	Ngritj a e ndërgj egjësi mit të sektor ëve publik ë, subjek teve raport uese dhe OJQ- ve rreth kërcën imeve të FT	Ngritj a e ndërgj egjësi mit të sektor ëve publik ë, subjek teve raport uese për identif ikimi e pronar ëve përfitu es	Rritja e aftësiv e dhe kapaci teteve inspek tuese dhe mbikë qyrëse	MFPT dhe NjIF-K	

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

[Jepni një paraqitje të shkurtër narrative të tre opsioneve. Gjithashtu paraqitni opsionin e zgjedhur dhe arsyet kryesore përse është zgjedhur.]

Figura 9: Krahasimi i opsioneve

Metoda e krahasimit:			
Ndikimet relevante pozitive	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit	Opsioni 3:
	Nuk ka ndikime relevante pozitive përkatëse.	Ka gjasa të rris numrin e rasteve të hetimeve të PP/FT.	Ngritja e numrit të rasteve të hetimeve të PP/FT.
		Mund të rris kapacitet profesionale në kuadër të institucioneve gjegjëse, por nuk e zgjedh problemin dhe sfidat	Ngritja e kapacitet profesionale në kuadër të institucioneve gjegjëse.
			Rritja e pajtueshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare të FATF dhe Direktivat e BE-së
			Rritja e gjasave për anëtarësime të mëtutjeshme në mekanizmat ndërkombëtarë dhe evropian në këtë fushë
			Ngritja e bashkëpunimin ndërkombëtarë
Ndikimet relevante negative	Sfida në parandalimin dhe luftimin e duhur të PP/FT	Sfida në parandalimin dhe luftimin e duhur të PP/FT	Ekzistimi i më shumë akteve ligjore që rezulton nga ndryshimi dhe plotësimi i ligjit bazik, pa ekzistuar praktika e paraqitjes zyrtare të versionit të konsoliduar të ligjeve në vendin tonë do mund të shkaktonte konfuzion.
	Vazhdimësi e mos pajtueshmërisë me	Vazhdimësi e mos pajtueshmërisë me	

	standardet ndërkombëtare të FATF dhe Direktivat e BE-së			standardet ndërkombëtare të FATF dhe Direktivat e BE-së					
	Kontribuon në perceptimin mbi punën jo të drejtë dhe jo profesionale të institucioneve të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjyqësorit sa i përket PP/FT			Ngecjet në anëtarësimet e mëtutjeshme në mekanizmat ndërkombëtarë dhe evropian në këtë fushë					
	Mos përmirësim në rritjen e numrit të rasteve të hetimeve dhe dënimeve për PP/FT.			Mos përmirësim në rritjen e numrit të rasteve të hetimeve dhe dënimeve për PP/FT.					
	Nuk do arrihet de-motivim i duhur i kryerësve potencial të këtyre veprave penale.			Pamundësi e mbikëqyrjes së duhur të pajtueshmërisë së subjekteve raportuese					
Kostot relevante	Brenda kufijve aktual buxhetorë			Brenda kufijve aktual buxhetorë			Brenda kufijve aktual buxhetorë		
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Përfundimi									

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si propozues i këtij Koncept Dokumenti, i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës të miratojë Opsionin 3 për ndryshime legislative përmes plotësim ndryshimit të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit e Financimit të Terrorizmit i cili mundëson parandalimin më efektiv të PP/FT, zbatimin e Planit të Veprimit të miratuar me datë 24/12/2020 me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/52 të rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit e Financimit të Terrorizmit, ngritjen e pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare të FATF dhe përfrimin me legjislacionin e BE-së, ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mundësinë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Në cilindo rast, miratimi i cilitdo nën-opcion nga opsioni 3 do të mundëson realizimin e pritjeve të lartcekura. Veç kësaj, Ministria konsideron që krahas ndryshimeve ligjore, do të ishte e rrugës të adoptohej edhe opsioni i dytë i cili parasheh përmirësimin e zbatimit të kornizës aktuale ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit në harmoni me rekomandimet e dala nga Raporti i Vlerësimit të vitit 2018 të pajtueshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, vlerësim i bërë nga ekspertët nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit me metodologjinë e MONEYVAL përmes Projekti PECK II në Kosovë. Në këtë mënyrë, jo vetëm që do të plotësohej korniza ligjore për PPP/LFT dhe avancohej pajtueshmëria me standardet ndërkombëtar dhe, mirëpo edhe do të përmirësohej zbatimi i kornizës veçse ekzistuese.

Pas aprovimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të fillojë hartimin e ndryshimeve legjislative, duke marrë në konsideratë analizën e zhvilluar në kuadër të këtij dokumenti.

Figura 10: Plani i zbatimit të opsionit të preferuar

[Shtoni Planin e Zbatimit për opsionin e preferuar.]

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

[Përshkruani dispozitat dhe planifikimin për monitorim dhe vlerësim. Nëse nuk nevojiten dispozita të tilla, shpjegoni pse.]

Tanimë këto dispozita ekzistojnë në kornizën aktuale ligjore, pasi që në ligjin aktual ekzistojnë dispozita për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë për subjektet raportuese, bashkëpunimi për mbikëqyrje të pajtueshmërisë, të dhënat statistikore dhe informatat kthyesë, kryerja e vlerësimit kombëtar të rrezikut, procedura e ndëshkimeve administrative, etj.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ⁹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		x			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		x			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		x			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllën?		x			
	A do të krijohen biznese të reja?		x			
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		x			
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?	x		Bankat, institucionet financiare dhe profesionet e lira (avokat, noter, kontabilist, auditor) dhe subjektet tjera	I ulët	

⁹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

				raportuese të përcaktuara sipas ligjit për PPP/LFT		
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		x			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		x			
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		x			
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		x			
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		x			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		x			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		x			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?	x				
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		x			
	A do të ulët çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		x			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		x			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		x			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		x			

Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	x		Bankat, institucionet financiare dhe profesionet e lira (avokat, noter, kontabilist, auditor) dhe subjektet tjera raportuese të përcaktuara sipas ligjit për PPP/LFT	I ulët	
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		x			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		x			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ¹⁰	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		X			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		X			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		X			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		X			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X			
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		X			
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		X			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		X			

¹⁰ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		x			
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		x			
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		x			
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		x			
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		x			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		x			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		x			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		x			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		x			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		x			
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	x				
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?		x			
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		x			

	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?	x			I ulët	
Shëndeti dhe siguria publike ¹¹	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		x			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		x			
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		x			
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		x			
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		x			

¹¹ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?	x			I lartë	
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?	x			I lartë	
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?	x			I lartë	
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	x			I lartë	
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		x			

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		x			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		x			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		x			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		x			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		x			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		x			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		x			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		x			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		x			

	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		x			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		x			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?		x			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		x			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		x			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		x			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		x			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		x			
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		x			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		x			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		x			

	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		x			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		x			
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		x			
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		x			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		x			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	x				
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	x				
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	x				

Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		x			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		x			
Trajtimi i barabartë ¹²	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	x				
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		x			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		x			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		x			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		x			
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		x			
	A ndikohet qasja në drejtësi?		x			

¹² Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*